



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i studimit me karakter profesional në:
“Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore”
Universiteti “Barleti”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Etleva Refatllari

Prof. Vjollca Durro

Tetor / 2024

**Tabela Përmbledhëse e të dhënave të programit të studimit me karakter profesional në:
“Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore”**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Barleti"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi me karakter profesional në: “Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 487, datë 27.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati nr. 10, datë 28.03.2023 Miratuar me shkresë MAS Nr. 2173/1, datë 28.04.2023
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 225, datë 31.10.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 56, datë 09.09.2022
8	Cikli i studimit:	Program studimi me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5 (pestë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 12 PAE/ 1 PAK 2023-2024 12 PAE/ 2 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023 3 studente 2023-2024 6 studente
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM


Universiteti Barleti (UBa) është institucion privat i arsimit të lartë, hapur me VKM 571, datë 12.8.2005 si Shkolla e lartë Universitare, Jo publike Universiteti "Marin Barleti" me dy fakultete, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe Fakultetin e Matematikës së Zbatuar. Universiteti gjatë viteve e ka zgjeruar aktivitetin e tij me fakultete dhe programe të reja si dhe ka pësuar riorganizime. Me Urdherin nr. 309, datë 27.07.2012, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, "Riorganizim i Brendshëm i Njesive Kryesore të Shkolles së Lartë Universitare Jo Publike "Universiteti "Marin Barleti"", organizohet në katër fakultete: Fakulteti i Ekonomisë dhe Financës, Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara. Me Urdhër 202, datë 25.05.2015 MARS dhe VKA nr 05.05.2015, Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike "Universiteti "Marin Barleti", organizohet me Fakulteti i Drejtësisë dhe shkencave Politike (5 njësi bazë) dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë (4 njësi bazë). Në vitin 2019 me Urdhërin nr. 511 datë 24.10.2019 të MARS "Universiteti Marin Barleti" Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale Politike riorganizohen në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit" me katër njësi bazë. Në vitin 2020 me Urdhërin nr. 213 datë 03.07.2020 të MASR Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike Universiteti "Marin Barleti" riorganizohet në Universiteti "Barleti" (UBa) me katër Fakultete:

1. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë;
2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative;
3. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit;
4. Fakulteti i Shkencave Mjekësore;

UBa është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 9 datë 7.04.2017 dhe riakredituar në vitin 2021 me Vendim BA Nr. 60, datë 16.12.2021 për një periudhë 5 vjeçare me vlefshmëri deri më 15.12.2026. UBa ofron programe studimi me karakter profesional, programe trajnimesh, testime dhe çertifikime për aftësimin e arsimit të vazhdueshme, programe të ciklit të parë, programe të ciklit të dytë dhe programe të ciklit të tretë të studimeve. Programi i studimit me karakter profesional në "Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore" zhvillohet në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit përbëhet nga katër departamente:

1. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional;
2. Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve;
3. Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit;
4. Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit;

Programi i studimit me karakter profesional në "Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore" zhvillohet në Departamentin e Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, miratuar me Urdhër MASR Nr.487, datë 27.07.2018 të MARS dhe ofrohet me 120 kredite (ECTS), kohëzgjatje 2 vite akademik, në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi. Në përfundim të studimeve lëshohet diplome profesionale në "Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore". Ky program është akredituar në vitin 2022 me vendim të Bordit të Akreditimit



Nr. 56, datë 09.09.2022 me kohëzgjatje dy vite. Plani mësimor i Programi i studimit është riorganizuar bazuar në rekomandimet e lëna nga BA Ndryshimet e bëra në programin e studimit janë në masën 20% dhe janë të miratuar me Vendim Senati nr. 10, datë 28.03.2023 dhe MAS me shkresë Nr. 2173/1, datë 28.04.2023.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit periodik të programit të studimit profesional në “Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore”, i ofruar nga Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit (FSHSTS). Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve për programin e studimit me karakter profesional, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 5 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykrimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në fazë të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. I gjithë dokumentacioni i referuar, jepet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks [aneks, lista e evidencave]. Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga **Prof.Dr. Etleva Refatlari**, dhe **Prof. Dr.Vjollca Durro**. Koordinatorja Teknike e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Anilda Beqiraj. Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.

- Vizita në UBa e zhvilluar në datat 17 Mars 2022. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UBa. GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në VBA Nr. 56, datë 09.09.2022 janë:

- Institucioni, të rishikojë kurrikulën e programit të studimit duke e përshtatur atë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
- Institucioni, të marrë masa që kualifikimi i personelit akademik, i angazhuar si lektor në këtë program studimi, të jetë në përputhje me aktet ligjore në fuqi;
- Institucioni, të marrë masa që, titullarët e lëndëve të angazhuar në këtë program studimi të jenë në përputhje me aktet ligjore në fuqi;
- Institucioni, të përfshijë në planin mësimor të këtij programi studimi, detyrimet përbyllëse të studentëve, në përputhje me nivelin dhe objektivat që ky program studimi synon si dhe me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi;
- Institucioni, të hartojë një studim të mirëfilltë të tregut të punës për të njohur nevojat reale në treg, të këtij programi studimi si edhe të rrisë promovimin e tij;
- Institucioni, të përditësojë rregulloren e departamentit përgjegjës për këtë program studimi dhe rregulloren e programit të studimit, me qëllim përcaktimin më të qartë të fushave të veprimtarisë;
- Institucioni, të përditësojë literaturën e përfshirë në syllabuset e këtij programi studimi;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. **Për rekomandimin e parë.** Është bërë riorganizimi programit të studimit bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për programet profesionale. Ndryshimet në programin mësimor janë në masën 20%. Në program janë përfshirë lëndët bazë dhe detyrimet përmbyllesë që mungonin. Është bërë një shpërndarje lëndëve në ETC sipas peshës specifike të parashikuar në VKM VKM nr.185 datë 25.03.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.1.2018. Për sa më sipër GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbylur plotësisht**.
2. **Për rekomandimin e dytë.** Ka lektorë të angazhuar në këtë program studimi të kategorisë Mcs. Ligji i arsimit të Lartë, neni 59 pika 6 thekson se personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Në kolegjet profesionale të larta, personeli akademik duhet të ketë fituar së paku diplomën “Master profesional”. Për sa më sipër GVJ vlerëson se ky rekomandim është **plotësuar**.
3. **Për rekomandimin e tretë.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se akoma ka titullarë të lëndëve të programit të studimit që nuk janë të kategorisë “Profesor”. Për sa më sipër GVJ vlerëson se ky rekomandim **nuk është plotësuar**.
4. **Për rekomandimin e katërt.** Programi i studimit është riorganizuar dhe përmban të gjitha elementët e organizimit në VKM nr.185 datë 25.03.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.1.2018. Ndryshimet janë në masën 20%. Për sa më sipër GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbylur plotësisht**.
5. **Për rekomandimin e pestë.** Nga IAL është kryer studimi i tregut ku pasqyrohen nevojat aktuale në vëndin tonë për specialiste “Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore”. Materiali përkatës ndodhet në dosjen e dokumentave të IAL. Për sa më sipër GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbylur plotësisht**.
6. **Për rekomandimin e gjashtë.** Institucioni, nuk ka bërë përditësimin e rregullores së programit të studimit. Në dosjen e dokumentave të dorëzuar në ASCAL elektronikisht nuk gjendet rregullorja e funksionimit të departamentit. Për sa më sipër GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbylur pjesërisht**.
7. **Për rekomandimin e shtatë.** Institucioni ka bërë rishikimin dhe përditësimin e literaturës të përfshirë në syllabuset e këtij programi studimi. Literatura bazë ofrohet në gjuhën shqipe (që është gjuha e programit të studimit) si dhe është në përgjithësi e 10 viteve të fundit, përbëhet nga publikime të lektorëve dhe cikle leksionesh të përgatitura dhe përditësuara çdo vit prej tyre. Për sa më sipër GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbylur plotësisht**.

Universiteti “ Barleti”, është njohur me DRVJ më datë 27.09.2024, përmes sistemit AMS, formë zyrtare me shkresë Nr 99/25 Prot date 27.09.2024. Kolegji nuk ka komente, dërguar këto me shkresën Nr 1159 Prot , datë 03.10.2024 . Në këtë mënyrë DRVJ merr formën përfundimtare si RVJ.

Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional në “Operator dhe Këshillues në përkujdesie Shëndetësore”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Barleti” (UBa) është institucion jopublik i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 571, datë 12.8.2005 me dy fakultete, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe Fakultetin e Matematikës së Zbatuar. UBa është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 9 datë 7.04.2017 dhe riakredituar në vitin 2021 me Vendim BA Nr. 60, datë 16.12.2021 për një periudhë 5 vjeçare me vlefshmëri deri më 15.12.2026. Gjatë viteve UBa ka shtuar programe dhe fakultetet të reja dhe ka pësuar disa riorganizime. Në vitin 2020 me Urdhërin nr. 213 datë 03.0.2020 të MASR Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike Universiteti "Marin Barleti" riorganizohet në Universiteti “Barleti” (UBa) si vijon: 1. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë; 2. Fakulteti i Shkencave të aplikuara dhe Industrive Kreative; 3. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit; 4. Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Fakultetet që janë në përberje të UBa e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat mjekësore, shkencat sociale dhe të aplikuara, shkencat ekonomike dhe të drejtësisë. Programet që ofron institucioni janë në përputhje me interesat dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit të vendit në përputhje me profilin e institucionit. Programet e studimit të ofruara nga institucioni kanë si qëllim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare dhe janë në përputhje të plotë me misionin e UBa, objektivat dhe fushën e veprimtarisë së Fakultetit të Shkencave

	Mjekësore, ekonomike, drejtesisë aposhkencave te aplikuar. <i>[takimi me dekanin, evidenca Nr.A.1.1. Statusi i institucionit, Rregullorja e Uba, Evidenca A1.4 Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	UBa ofron programe studimi me karakter profesional, programe trajnimesh, testime dhe çertifikime për aftësimin e arsimit të vazhdueshme, programe të ciklit të parë, programe të ciklit të dytë dhe programe të ciklit të tretë të studimeve. Programi i studimit me karakter profesional në “Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore”(OKPSH) zhvillohet në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit(FSHSTS). Ky Fakultet përbëhet nga katër departamente Programi i studimit OKPSH synon përgatitjen e profesionistëve në fushën respektive nëpërmjet ofrimit të kurikulave formuese dhe trainuese dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e Fakultetit të FSHSTS si dhe UBa duke i shërbyer zhvillimit social, kulturor dhe ekonomik të shoqërisë shiptare si dhe përparimit të arsimit të lartë dhe kërkimor shkencor në nivel kombëtar. Programi i studimit është në përputhje me qëllimin, dhe veprimtarinë e institucionit për ofrimin e arsimit profesional cilësor dhe me standarte Europiane nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor për përgatitjen e individëve të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv. <i>[takimi me dekanin, evidenca Nr.A.1.1. Statusi i institucionit rregullorja e Uba, evidenca A1.4, strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030, Ev. A.3.12. Strategjia e zhvillimit të programit profesional.]</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Drejtimet prioritare akademike të institucionit janë përcaktuar në dokumentat themelore të tij si Rregullorja e UBa miratuar me Vendim Nr. 60, datë 13.04.2021 të Senatit Akademik, Statuti i UBa miratuar me Urdhër Nr. 360 , datë 23.12.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe ndryshuar me vendim nr 78 datë 9.02.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve”Për miratimin e një ndryshimi në Statusin e UBa”, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve miratuar me Vendim Nr. 64/1, datë 13.04.2021 të Senatit Akademik , Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030, miratuar me vendim të Bordit të Administrimit me nr. 111 Prot, datë 16.02.2021 si

	dhe Strategjia e zhvillimit te programit profesional. UBa ka hartuar dhe miratuar edhe rregulloret e njësive dhe strukturave të tjera si rregullorja e departamentit, rregullorja e programit të studimit, rregullore NJSBC, rregullore e sekretarisë, rregullore e zyrës së burimeve njerëzore, Rregullore e brendshme per transferimet 2023,. Rregullore e funksionimit te zyrave ne sherbim te studenteve prane UBa.etj. Ky program studimi është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor të UBa, statusin e e zhvillimit të UBa si dhe rregulloret e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve . Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni i vlerësuesve të jashtëm konstaton se Rregullorja e programit të studimit “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” (evidence A3.3 miratuar me vendim të senatit akademik datë Nr 70/8 datë 13.04.2021) nuk është rishikuar sipas rekomandimeve të lëna në akreditimin e parë. <i>GVJ rekomandon sërish rishikimin e rregullores së programit të studimit.</i> <i>[evidenca nr.A.1.statusi i UBa, evidenca A.1.3 Rregullorja e Uba; Evidenca A.1.21 Rregullorja e sekretarisë mësimore, Evidenca A.1.22. Rregullore e brendshme per transferimet 2023.pdf; Evidenca A.1.23, Ev. A.3.12. Strategjia e zhvillimit te programit profesional, Evidenca A.1.9. Rregullore e NJZHKC.]</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Në takimin me drejtuesit e FSHSTS u theksua se realizimi i programit dhe vazhdimësia e tij bazohet dhe në studimit e tregut të punës. Në vendin tonë ky program nuk egziston në IAL publike apo private. Nga studimi i tregut të punës UBa ka konstatuar se ky program studimi nuk egziston as në vendet ballkanit si Kosova, Maqedonia e veriut, Kështu që nevojat për këtë profesion janë të medha si në Shqipëri ashtu dhe vëndet e rajonit apo BE. <i>Hapja e këtij programi studimi vjen si bashkëpunim me një nga vëndet e BE, Italia ku ky profesion egziston dhe funksionon prej vitesh.</i> <i>[takimi me dekanin e fakultetit, RVB, Ev. A. 3.2. Misioni dhe Studimi i tregut te punes per OKPSH.pdf]</i>

Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti “Marin Barleti” ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë, programe të ciklit të tretë të studimeve, programe me karakter profesional, programe trajnimesh, testime dhe çertifikime për aftësimin e arsimin të vazhdueshme, Në përbërje të tij janë katër fakultete që e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat mjekësore, sociale , ekonomike, juridike dhe shkencat e aplikuar. Kjo tregon se tashmë institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon dhe burime njerëzore në staf akademik dhe mbështetës. Programi i studimit “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore realizohet në Departamentin e Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit të Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve (FSHSTS) miratuar me Urdhër Nr.487, datë 27.07.2018 të MARS. Institucioni ka kapacitetet, burimet financiare dhe logjistike të mjaftueshme, që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit, me një numër më të madh studentësh se aktualisht (9 studentë). Për realizimin e praktikës profesionale të studentëve FSHSTS dhe UBa kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike dhe jo publike si Qendrën e përkujdesit për të moshuarve Moza, QSUNT, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Spitalin Salus si dhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ngjashme me Italinë. <i>[Eivencia A.2.9 marrveshje te bashkëpunimit institucional, Aneks Tabela RVB per OKPSH]</i>
Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit me karakter profesional Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore, zhvillohet nga Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve (FSHSTS) dhe përputhet me fushën akademike dhe kërkimore të tij. FSHSTS përbëhet nga katër departamente: • Departamenti i shkencave të edukimit dhe trajnimit profesional; • Departamenti i edukimit fizik dhe sporteve; • Departamenti i turizmit, mikritjes dhe rekreacionit; • Departamenti i shkencave të sjelljes dhe shëndetit;

	Në FSHSTS për vitin akademik 2023-2024 sipas departamenteve zhvillohen 19 programe studimi si vijon: - Departamenti i shkencave të edukimit dhe trajnimit profesional realizohen 7(shtaët) programe në Mastër Profesional. - Departamenti i edukimit fizik dhe sporteve realizon pesë programe studimi si vijon a) Një program në MP b) Dy programe Bachelor c) Një Master shkencor d) Një program doktorature -Departamenti i turizmit, mikritjes dhe rekreacionit realizon dy programe studimi a) Një program në MP a) Një program Bachelor -Departamenti i shkencave të sjelljes dhe Shëndetit realizohen 5 programe studimi: b) Një Program profesional në Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore c) Dy programe Bachelor d) Bachelor në Punë Sociale e) Dy programe në Mastër shkencor. Zhvillimi i procesit mësimor në FSHSTS, si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi realizohet nga pedagogë efektive (PAE) dhe pedagogë me kontratë (PAK) të cilët zotërojnë tituj akademik dhe grada shkencore. Profili i programit të studimit dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tij përputhet me atë të njësisë kryesore. <i>Evidenca A.1.9. Rregullore e NJZHKC, Evidenca A3.3.Rregullorja e programit të studimit, Aneks Tabela RVB per OKPSH.J.</i>
Konkluzione	<i>Programet që ofron UBa janë në përputhje me profilin e institucionit me qëllim ofrimin e arsimit cilësor dhe me standarte Euorpiane nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor për përgatitjen e individëve të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv.</i>

	<i>-Programi i studimit me karakter profesional Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore, zhvillohet nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve (FSHSTS) dhe përputhet me fushën akademike dhe kërkimore të tij.</i> <i>-Institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon dhe burime njerëzore në staf akademik dhe mbështetës.</i> <i>-Institucioni ka kapacitetet, burimet financiare dhe logjistike të mjaftueshme, që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit, me një numër më të madh studentësh se aktualisht (9 studentë).</i> <i>-GVJ rekomandon sërish rishikimin e rregullores së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UBa është një institucion që funksion në bazë të akteve rregullatore, bashkëpunimit dhe koordinimit brënda institucionit të stafit akademik, administrativë dhe stafit mbështetës. Aktet ligjore rregullatore përcaktojnë organizimin, funksionimit, detyrimet dhe përgjegjësitë e stafit sipas pozicionit dhe funksioneve që kryejne në strukturat e universitetit, fakultetit apo programit të studimit ku ata janë të angazhuar. Disa prej anëtarëve të personelit akademik mbulojnë pozicione të ndryshme në strukturën e institucionit ose angazhuar në komisione “ad hoc” të ngritura për tematika të ndryshme. Në mënyre periodike njësia kryesore, njësiti bazë, programet e studimit dhe njësiti mbështetëse si NJSBC, sekretaritë mësimore, këshillimi i karrierës, kyejnë analizën e aktivitetit të tyre, nxjerrin përfundimet dhe përcaktojnë masat që duhen të meren në zgjidhjen e problematikave të ndryshme apo përmirësimet e nevojshme. Në komunikimin e brendshëm midis stafit të

	institucionit një rol të rëndësishëm luan sistemi i komunikimit elektronik nëpërmjet se cilit realizohet shkëmbimi dhe përditësimi i informacionit, ndarja e punës etj. Sikundër u theksua edhe gjatë vizitës në institucion nga drejtuesit bashkëpunimi dhe koordinimi brenda institucionit zhvillohet në normalitet. <i>[takimi me dekanin, shefin e departamentit, stafin akademik, evidenca nr.A 2.10.1 dhe 2.10.2 Analiza vjetore e departamentit viti 2021-2022 dhe 2022-2023].</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	UBa është një institucion jo publik që ka një numër të vogël studentësh në këtë program studimi sepse ky është një program i ri, 4 vite akademike (2018-2024), por jo në numër programesh që ofron <i>[Rregullorja e UBa]</i>. Në funksion të programit profesional të studimit “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore”, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon si dhe ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, me institucionet publike dhe jo publike, OJF, institucione shëndetësore. Pranë këtij departamenti është ngritur dhe Bordi i karrierës me përfaqësues nga departamenti, institucione shëndetësore, OJ, Urdhëri psikologut. Për këtë program studimi UBa ka marrëveshje bashkëpunimi me Italinë, Qendrën e perkujdesit për të moshuarve Moza, QSUNT, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Spitalin Salus. Këto Marrëveshje bashkëpunimit me kompani apo institucione të ndryshme u mundësojnë studentëve kryerjen e praktikës profesionale, intershipe të cilat ju shërbejnë për thellimin e njohurive dhe përfitim të aftësive dhe kompetencave profesionale si dhe vendosjen e kontakteve me biznesin për punësimin e tyre. <i>[RVB, takimi me stafin drejtues, evidenca nr. A.2.9 marrveshje te bashkëpunimit institucional, Ev. A.3.13 Marrveshjet e bashkepunimit OKPSH].</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave	Institucioni ka të dhëna lidhur me institucionet të sipërcituara ku, studentët kryejnë praktikën profesionale bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka institucioni. Praktika mbikqyret nga një pedagog i caktuar si dhe kordinatori i programit i cili koordinon me institucionin ku studenti realizon praktikën profesionale. Realizimi i praktikës dhe vlerësimi kryhet sipas udhësuesi “Paketa e praktikës” dhe rregullores përkatëse të programit të studimit OKPSH.

profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.	<i>[ev.A3.6 dokumenti praktikës, takimi me stafin akademik, evidenca nr A.3.3. Rregullorja e programit të studimit].</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit ku zhvillohet ky program studimi, në mënyrë periodike harton raportin mbi realizimin e programit mësimor, opinionin e studentëve lidhur me logjistikën në funksion të programit, aktivitetet të kryera gjatë vitit akademik në funksion të programit të studimit. Të dhënat e raporteve i shërbejnë departamentit për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, hartimin e politikave të zhvillimit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Numri i studentëve në programin profesional “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” ka qenë i pakët dhe konstatohet një rrënie të numrit të studentëve. Për vitin akademik 2018-2019 janë rregjistruar tetë studentë, për vitin akademik 2019-2020 dymbëdhjetë studentë dhe vitin 2020-2021, katër studentë, vitin 2022 -2023 3(tre) studentë dhe 2023-2024 5 studentë. <i>[takimi me stafin drejtues, Aneksi tabela, Ev. A.3.15 Raport per vleresimet e studeteve 2022-2023.]</i>
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Njësia bazë ku realizohet ky program studimi në bashkëpunim me Bordin e karrierës dhe institucionet të tjera organizon aktivitete të ndryshme si vizita institucionale, aktivitete ekstrakurrikulare trajnime të ndryshme, seminare të cilat i shërbejnë përditësimit të kurikulës/syllabuseve si dhe ndihmon studentët për tu përshtatur kërkesave të tregut të punës dhe marrjen e informacioneve për mundësi punësimi. <i>[takimi me stafin drejtues, RVB, dokumenti Trajnime te mëtejshme profesionale për studentët e diplomuar, evidenca A.2.10.1 dhe A.2.10.2.Analiza vjetore e departamenti, ev.A2.11b Aktivitete ekstrakurrikulare FSHM]</i>
Konkluzione	-UBa është një institucion që funksion në bazë të akteve rregullatore, bashkëpunimit dhe koordinimit brënda institucionit të stafit akademik, administrativë dhe stafit mbështetës. -Për realizimin e programit profesional të studimit “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore”, institucioni ka infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme.

	<i>IAL ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, me institucionet publike dhe jo publike, OJF, institucione shëndetësore për realizimin e programit dhe realizimin e praktikës profesionale.</i> <i>Pranë njesise baze ku realizohet ky program studimi është ngritur dhe Bordi i karrierës me përfaqësues nga departamenti, institucione shëndetësore, OJ, Urdhëri psikologut dhe biznesi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Ligjin e arsimit të Lartë 80/2015 dhe aktet rregullatore institucionale UBa ka ngritur strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brëndshemë të Cilësisë në nivel institucional, Njesisë kryesore dhe bazë si dhe kordinatorin në nivel programi studimi përgjegjës për cilësinë i cili monitoron e vlerëson periodikisht cilësinë e programit të studimit. Strukturat përgjegjëse për cilësinë janë: -Njësia e zhvillimit kurikular dhe Cilësisë që është ekuivalenti i NJSBC-së, dhe funksionon në bazë të rregullores së “Për funksionimin e Njesisë së zhvillimit kurikular dhe Cilësisë në UBa” miratuar me vendim të senatit Akdemik Nr 58 datë 10.03.2021. Kjo njësi përbhet nga drejtuesi i njesisë dhe 3 koordinatorë. Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, i cili funksionon në bazë të rregullores së “Për funksionimin e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë” miratuar me vendim të senatit Akdemik Nr 63 datë 13.04.2021. Komisioni përbëhet nga 5(pesë) anëtarë, katër prej të cilëve janë staf i punësuar me kohë të plotë në UBa dhe i përkasinë kategorisë profesor dhe një është përfaqësues i studentëve. Komisioni ka një mandat dy vjecar me të drejtë rizgjedhje. Kjo njësi monitoron dhe mbikqyr realizimin në praktikë të

	planit të veprimit të Vlerësimit të cilësisë të miratuar nga Rektori Uba dhe koordinon të gjitha aktivitetet që kanë si qëllim sigurimin e cilësisë dhe promovimin e kulturës së cilësisë në njësitë përkatëse Grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë të cilët janë përgjegjës për procesin e vetëvlerësimit dhe implementimin e programit të cilësisë. Ky grup përbehet nga përfaqësues i stafit, një student dhe drejtues i njësisë kryesore dhe ngrihet pranë cdo njësie baze. <i>[Evidenca A1.9 Rregullore e Njësisë së zhvillimit kurikular dhe Cilësisë; Evidenca A1.19 "Për funksionimin e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, Evidenca A1.27 Manuali I cilësisë]</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Strategjinë e zhvillimit institucional të UBa 2020-2030 ka përcaktuar objektiva konkrete dhe të matshme lidhur me sigurimin e cilësisë së procesit akademik, të cilat do të përmbushen me anë të bashkëpunimit të gjithë strukturave përgjegjëse për cilësinë në UBa dhe komisionit të vlerësimit të performancës. Sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nga institucioni nëpërmjet strukturave drejtuese sipas hierarkisë organizative të UBa të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave institucionale, strategjive dhe procedurave lidhur me zbatimin e cilësisë dhe Njësisë së zhvillimit të kurrikulave dhe standarteve të cilësisë, e cila vlerëson rezultate të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore në nivel UBa. Pjesë e strukturave të cilësisë janë studentët dhe ekspert nga fusha e biznesit. <i>Evidence A1.4 strategjia e zhvillimit institucional të Uba 2020-2030</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe	Për përmirësimin vazhdueshëm të cilësisë institucioni përdor metodologji të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në drejtimet kryesore si hartimin e programeve të studimit, planit mësimor, hartimin e syllabuseve, përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies, kërkimin shkencor etj. Vetëvlerësimi dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë janë një proces i vazhdueshëm dhe i shërbejnë vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe akreditimit institucional apo programeve të studimit të gjitha rezultate të raporteve vlerësuese apo

proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	rekomandimete lëna gjatë procesit të akreditimit shërbejnë për marrjen emasave korrigjuese dhe përmirësimin emëtejtshëm të cilësisë së procesit akademik. <i>[A.1.29. Raport për vlerësimin dhe cilësinë, Evidencat A.1.19. Rregullore e komisionit të sigurimit të standardeve të cilësisë Takimet në institucion]</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.	Institucioni për vlerësimin e cilësisë përdor disa burime ndryshme dhe të dhëna sic është informacioni i mbledhur nga studentët, pedagogët, drejtuesit e Njësive kryesore, bazë, koordinatorët e programeve, komisionete vlerësimit të brendshëm dhe jashtëm të cilësië. Për mbledhjen e të dhënave përdoren një sërë mekanizma si pyetësor (të studentëve, petagogëve) formularët e vlerësimit dhe vetëvlerësimit, intervistat, focus grupe, skeda vrojtimi, raportet vlerësuese Të gjithë këto mëkabhizma shërbejnë për të vlerësuar metodat e mësimdhënies punen e petagogut, syllabuset, programin estudimit etj.) Rezultatet e mbledhura përpunohen, përgatiten raportet të cilat miratohen nga rektori dhe me tej i përcillen njësisë bazë. Departamenti luan një rol të rëndësishëm në monirotime cilësisë me anë të mekanizmave të tij të brendshëm si relacionet e pedagogëve për lëndën etj. NJZHKDC harton raportin vjetor lidhur me sigurimin ecilësisë në UBa dhe publikohen ne faen e ëebit te UBa dhe sistemin e ebrëndhëm të UBa INTRANET ku ju vihet en dispozicion stafit dhe studentëve. Të dhënat e përpunuara nga pyetësorët shërbejnë për promovimin e praktikave të mira, inkurajimin e stafit akademik për përmirësim të vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, të kuurikulave mësimore, hartimin dhe miratimin e proçedurave për përzgjedhjen e tekseve mësimore, aplikimin e teknologjisë mësimore, përmirësime të infrastrukturës mësimore etj. <i>[Evidencat A.1.19. Rregullore e komisionit të sigurimit të standardeve të cilësisë, A.1.15. Format i raportimit te punes semestrale, Evidencat A.1.10. Formular vlerësimi koleg-koleg, A.1.11. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën]</i>
Konkluzione	-UBa ka ngritur strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brëndshemë të Cilësisë në nivel institucional, Njësive kryesore dhe bazë si dhe kordinatorin në nivel programi studimi të cilat implementojnë, monitorojnë dhe vlerëson

	periodikisht cilësinë e programit të studimit bazuar në ligjin e arsimit të lartë nr80/2015 dhe aktet rregullatore institucionale. -Strategjia e zhvillimit institucional të UBa 2020-2030 ka përcaktuar objektiva konkrete dhe të matshme lidhur me sigurimin e cilësisë së procesit akademik. -Institucioni për vlerësimin e cilësisë përdor metodologji të drejta dhe të tërthorta, burime ndryshme dhe të dhëna të shumta. Mekanizma për vlerësimin e cilësisë së përdorur janë pyetësre (të studentëve, pedagogëve), formularët e vlerësimit dhe vetëvlerësimit, intervistat, focus grupe, skeda vrojtimi, raportet vlerësuese. -Vetëvlerësimi dhe siguri i brendshëm i cilësisë janë një proces i vashdueshëm dhe i shërbejnë vlerësimit të jashtëm të cilësisë, akreditimit institucional dhe programeve të studimit. -Të gjitha rezultate e raporteve vlerësuese apo rekomandime të lëna gjatë procesit të akreditimit shërbejnë për marrjen e masave korrigjuese dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së procesit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me	Programi i studimit profesional “Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore”, është licensuar me Urdher MASR Nr. 487, date 27 Korrik 2018. Sipas dokumentit të hapjes UMASR Nr. 487, datë 27.07.2018, programi ka filluar veprimtarinë akademike në vitin akademik 2018-2019. Emri

karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	i programit në UMASR Nr. 487 është "Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetsore" Akredituar me Vendim BA Nr. 56, datë 09.09.2022 për një periudhë 2 (dy) vjetare. IAL ka bërë ndryshime në planet mesimore deri në masën 20% me vendim të senatit akademik nr. 10, datë 28.03.2023, miratuar me shkresë MAS Nr. 2173/1, datë 28.04.2023. Ky program studimi i referohet nivelit të 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), është organizuar me 120 kredite (ECTS), kohëzgjatje 2 vite akademik, në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë profesionale në "Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore" referuar nivelit të 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) <i>[rregullorja e FSHSTS, Ev A3.3 rregullorja programit profesional].</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.	Programi profesional në OKPSH synon dhënien e njohurive të konsolidura profesionale dhe aftësive praktike në fushën e përkujdesjes shëndetësore. Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Në kurrikulën e tij përfshihen lëndë specifike për ofrimin e kujdesi shëndetësor në situata të veçanta që lidhen me nevojat e tregu të punës, lëndë specifike që lidhen me formën e tyre profesionale dhe aftësive të komunikimit. Programi i studimit profesional OKPSH përmban një informacion të plotë në fushën e përkujdesjes shëndetësore nëpërmjet ndërthurjes së informacione dhe njohurive të shkencave mjekësore me ato të shkencave sociale. <i>[Ev. A.3.7.1 Plani mesimor OKPSH 2022. Ev.A.3.7.2 Plani mesimor ndryshuar 20%, Ev. A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH..]</i>
Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që	Kurikula dhe përmbajtja e Programit të studimit krijojnë mundësi studentit për formimin e tij profesional në fushën e ofrimit të përkujdesjes shëndetësore. Niveli i dijeve të ofruara në programet e lëndëve është i përshtatshëm për formimin e tyre profesionale dhe ofron njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike në fushën e shkencave mjekësore dhe sociale, për aftësimin dhe zhvillimin e kompetencës profesionale të

duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	studentëve si këshillues dhe ofrues të përkuqjesit shëndetësor për tu përshtatur kërkesave të tregut të punës jo vetëm brënda vëndit po dhe jashtë tij. Njohuritë e mara në këtë program dhe kurikula e tij ju krijon mundësi punësimi studentëve në struktura shëndetësor spitalore, struktura shëndetësore të kujdesit pajlativë, shtëpitë e kujdesit geriatrik, OJF që ofrojnë këshillim dhe përkuqjesje shëndetësore. <i>[Ev. A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH. Ev. A.3.7.1 Plani mesimor OKPSH 2022, Ev. A.3.9 Syllabuse 2022-2023; 2023-2024.]</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit është riorganizuar sipas rekomandimeve të BA Nr. 56, datë 09.09.2022 dhe përmban të gjitha elementët e organizimit në VKM nr.185 datë 25.03.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.1.2018. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët duke përfshirë kreditet për praktikës profesionale e cila në total ka 240 ore(60 orë në cdo semester) dhe detyrimet përmbyllëse si vijon: - Lendet bazë 10%; - Lëndët karakterizuese 55%; - Lëndë ndëdisiplinore /integruese 10%; - Lëndë plotësuese 20%; - Detyrime përmbyllëse 3-5%; <i>[Ev. A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH. Ev. A.3.7.1 Plani mesimor OKPSH 2022, Ev.A.3.7.2 Plani mesimor ndryshuar 20%]</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Ne takim me strukturat drejtuese të UBa dhe njësisë kryesore u theksua se në këtë program studimi nuk ka studentë me aftësi ndryshe.

Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit profesional OKPSH përmban një informacion të plotë në fushën e përkujdesjes shëndetësore ku ndërthuren informacione dhe njohuri të shkencave mjekësore me ato të shkencave sociale. Në vëndin tone si dhe në rajonin e Ballkanit nuk egziston një program i njashëm. Gjatë takimin me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se programi është i ngjashëm me programe të tjera ndërkombëtare pasi dhe hapja e këtij programi bazohet në eksperiencën Italiane (për shkak të mungesë së eksperinacvë të ngjashme në vëndin tonë si dhe në vendet fqinjë) duke ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës për këtë profesion dhe mungesën e profesionistëve të tillë në tregun e punës në Shqipëri. Kjo ju mundëson studentëve punësimin jo vetëm në shqipëri po dhe në vëndet e rajonit dhe vënde të tjera të BE. Programi i studimit ju mundëson studentëve transferimin e tyre në programe të ngjashme jashtë vëndit. Proçesi i transferimt dhe njohjes së kreditëve bëhet sipas rregullores së UBa dhe programit të studimit. <i>(Referuar takimit me stafin drejtues të Uba dhe stafin akademik Ev. A.3.7.1 Plani mesimor OKPSH 2022). takimi me stafin akademik]</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Kodifikimi i programit është kryer nga MASR dhe percillet institucionit me shkresen Nr prot 431, datë 27.03 2023 “Kodet e propozuara per programet e studimit ofruar nga universiteti Barleti”.
Konkluzionie	-Ky program studimi i referohet nivelit te 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), është organizuar me 120 kredite (ECTS), kohëzgjatje 2 vite akademik, në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi. -Kurikula dhe përmbajtja e Programit të studimit krijojnë mundësi studentit për formimin e tij profesional në fushën e ofrimit të përkujdesit shëndetësor. - Programi i studimit ka përcaktuar ngarkesen në kredite për të gjitha lëndët duke përfshirë kreditet për praktikës profesionale e cila në total ka 240 ore (60 orë në cdo semester) dhe detyrimet përmbyllëse 3-5%. - Në përfundim të studimeve lëshohet diplome profesionale në “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore”

	<i>referuar nivelit të 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	UBa është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutit të tij dhe zhvillon aktivitetin e tij në selinë në Tiranë. Institucioni përbëhet nga njësitë kryesore, bazë, ndihmës akademike dhe administrative dhe organet këshilluese(bordet e ndryshme) të organizuara në pesë shtylla si vijon: - shtylla akademike; - shtylla studentit; - shtylla e kërkimit të aplikua dhe inovacionit; - shtylla korporative dhe administrative; - shtylla sipërmarjes; Shtylla akademike përbëhet nga njësitë kryesore, njësitë bazë, organet kolegjiale dhe autoritet drejtuese. Organet kolegjiale drejtuese të UBa janë Senati akademik, rektorati, Këshilli etikës dhe shanceve të barabarta, Komisioni i sigurimit të cilësisë, Komisioni i vlerësimit të performancës dhe Asambleja e stafit akademik. Organet kolegjiale drejtuese të Fakultetit janë Dekanati dhe Asambleja e stafit akademik të fakultetit. UBa ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional në vitin 2017 me vendim të BA nr.9, datë 07.04.2017 dhe dhe riakredituar në vitin 2021 me Vendim BA Nr. 60, datë 16.12.2021 me vlefshmeri akreditimi deri në vitin 2026. Shtylla- Organizimi administrative dhe korporativë. Organet administrative janë bordi i administrimit, administratori i universitetit, administratori i deleguar, sekretari përgjithshëm, njësi kryesore [statusi i UBa). Shtylla e kërkimit të aplikuar dhe inovacionit përfshin departament ku zhvillohet aktiviteti

kërkimor shkencor, qendra dhe shoqata (OJF) me aktivitet kërkimor aplikativ dhe inovativ në mëbshtetje të punës akademike dhe iniciativa të tjera brënda institucionit. Shtylla e sipërmarrjes fokusohet në veprimtaritë e sipërmarrjeve të ngritura nga universiteti.

Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit i organizuar në katër departamente:

1. Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve;
2. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional;
3. Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit;
4. Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit;

Në Departamentin e shkencave të sjelljes dhe Shëndetit zhvillohen gjashtë programe studimi si vijon:

- a) Program profesional në Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore
- b) Bachelor në Psikologji
- c) Bachelor në Punë Sociale
- d) 3(tre) Mastër shkencor.

Për realizimin e programeve të studimit në njësinë kryesore dhe njësinë bazë janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë të kualifikuar që zotëorjnë tituj dhe grada shkencore.

Përbërja e stafit akademik në njësinë kryesore për vitet akademike 2022-2024 është si vijon :

Për vitin akademik 2022-23 janë angazhuar 36 (tridhjetë e gjashtë) PAE dhe 39 (tridhjetë e nëntë) PAK. Në stafin PAE 5 (pesë) janë të kategorisë professor 12 (dymbëdhjetë) janë doktorë shkencash dhe 19 (nënëmbëdhjetë) janë Msc. Nga PAK 3(tre) janë të kategorisë professor, 15 (pesëmbëdhjetë) doktorë shkencash, 21(njëzetnjë) janë Msc.

Për vitin akademik 2023-24 janë angazhuar 37 (tridhjetë e shtatë) PAE dhe 42 (dyzetedy) PAK. Në stafin PAE 5 (pesë) janë të kategorisë professor 13 (trembëdhjetë) janë doktorë shkencash dhe 19 (nënëmbëdhjetë) janë Msc. Nga PAK 6(gjashtë) janë të kategorisë professor, 23 (njëzetetre) doktorë shkencash, 13(trembedhjetë) janë Msc.

Këto të dhëna janë përmbledhur ne tabelën e mëposhtme.

Stafi akademik i Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në dy vitet akademike.

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	1	2
Prof. Asoc.	4	2	4	4
Dr./PhD.	12	15	13	23
Msc.	19	21	19	13
Totali	36	39	37	42

Stafi akademik i angazhuar në zhvillimin e procesit mësimor në njësinë bazë (departamenti shkencave të sjelljes dhe shëndetit) përgjegjëse për zhvillimin e këtij programi mësimor për vitet akademik 2022-2024 *referuar tabela 1 në dokumentin Aneks Tabela përmbledhëse* është si vijon:

Për vitin akademik 2022-2023 janë angazhuar 7 (shtatë) PAE dhe 14 (katërmëdhjetë) PAK. Në stafin PAE, 1(një) është nga kategoria professor, 5(pesë) janë doktorë shkencash dhe 1(një) është Msc. Nga PAK 9(nëntë) janë nga kategoria doktorë shkencash dhe 5(pesë) janë Msc.

Për vitin akademik 2023-2024 janë angazhuar 7 (shtatë) PAE dhe 12 (dy) PAK. Në stafin PAE, 1(një) është nga kategoria professor, 5(pesë) janë doktorë shkencash dhe 1(një) është Msc. Nga PAK 1 (një) është nga kategoria professor, 9(nëntë) janë doktorë shkencash dhe 2(dy) ë Msc.

Ndërsa të dhënave referuar tabela 2 në dokumentin Aneks *Tabela përmbledhëse* për stafin akademik të njësisë bazë, Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit në dy vite akademike 2022-2024 është si më poshtë vijon:

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-
Prof. Asoc.	1	1	1	1
Dr./PhD.	4	-	5	-
Msc.	2	1	1	1
Totali	7	2	7	2

Tabela përmbledhëse.

	Nga shqyrtimi i të dhënave të stafit akademik të njësive bazë GVJ konstaton mospërputhje të të dhënave midis tabelës 1 dhe tabelës 2 në dokumentin Aneks Tabela përmbledhëse. Për këtë arsye ne nuk mund të shprehemi për për raportin PAE/PAK. <i>[Dokumenti. Aneks Tabela përmbledhëse për OKPSH. Ev. A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH, Evidenca A.1.3. Rregullore e UniBa.]</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Në këtë program studimi është angazhuar staf ndihmës akademik dhe ndihmes administrative për realizimin e programit mësimor, realizimin e praktikave mësimore, praktikave profesionale në mbështetje të studenteve. Departamenti ka dhe një person akademik që ndjek praktikën profesionale. <i>[Aneks Tabela RVB për OKPSH., takimi me stafin drejtues]</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinators të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Institucioni ka një koordinator për çdo departament i cili koordinon mardhëniet midis studentëve dhe departamentit për të gjitha programet që ofron departamenti. Programi ka i caktuar një pedagog nga departamenti në përputhje me formimin e tij profesional si dhe një pedagog me kontratë nga Fakulteti i Shkencave mjekësore për organizimin dhe mbarëvajtjen e praktikës profesionale. <i>[takimi me stafin drejtues, evidenca A2.17 Lista e stafit akademik]</i>
Konkluzione	-Programi i studimit profesional "Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore", është licensuar sipas legjislacionit në fuqi dhe është Akredituar me Vendim BA Nr. 56, datë 09.09.2022 për një periudhë 2 (dy) vjetecare. -Stafi akademik i angazhuar në realizimin e këtij program studimi është i kualifikuar me tituj dhe grada shkencore në përputhje me ekspertizën që ofrojnë. -Institucioni ka një koordinator për çdo departament i cili koordinon mardhëniet midis studentëve dhe departamentit për të gjitha programet që ofron departamenti. -Programi ka caktuar një pedagog nga departamenti në përputhje me formimin e tij profesional si dhe një pedagog me kontratë nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore për

	organizmimin dhe mbarëvatjen e praktikës profesionale. -Nuk ka përputhje të të dhënave për stafin akademik të njësisë bazë midis tabela të paraqitura në dokumentin Aneks tabela përmbledhëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstaton se departamenti disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi nga petagogu i çdo lënde si dhe sekretaria mësimore. Dokumentacioni i programit të studimit përfshin: informacion për institucionin, informacion për stafin akademik, syllabuset e lëndëve. <i>Evidenca A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se struktura e programit të studimit Programi i studimit profesional “Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore” përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuar në VKM nr.185 datë 25.03.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.1.2018 Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në 2 vite akademike të ndara në 4 semestra. Numri i ECTS është 60 ECTS për çdo vit akademik, në total 120 ECTS prej të cilave 1260 orë në auditorë, 24 ETC ose 240 ore praktika profesionale(cila kryhet sipas syllabusit përkatës dhe programit kalendarik në çdo semestër) dhe Diploma 60 ore. Programi mësimor është i organizuar në leksione, seminare, ushtrime/laboratore. Pjesë e programit të studimit është dhe praktika profesionale. Plani

	mësimor përshin lëndet/disiplinat, praktikën dhe mbrojtjen e tezës si dhe veprimtari jashtë kurrikulare. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, ushtrimev, praktikave, detyrave të kursit, prezantimeve. Frekuentimi i orëve teorike dhe praktike është i detyrueshëm për studentin në masën 50% për leksionet, 75% për praktikën profesionale, seminare dhe labororet. Kohëzgjatja e orëve të mësimit është 50 minuta. <i>[Evidenca A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH, Evidenca A3.9 Syllabuset. Evidence 3.7,1-2 planet mesimore]</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstaton se institucioni ka informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit. Në takimin me studentët rezultoi që studentët kishin informacion dhe institucioni aplikon kritere specifike përzgjedhëse në pranimin e tyre. <i>[Evidenca A.1.20. Manual rekrutimi aplikim regjistrim transferim i studenteve. Evidenca A.1.22. Rregullore e brendshme per transferimet 2023]</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikë, seminar apo orë të laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit përmban informacionin lidhur me syllabuset që zhvillon në programin e studimit profesional “Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore” Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi tematikën e lëndës, ndarjen në leksione, seminare, praktikë mësimore/ profesionale, ECTS përkatëse, literaturën përkatëse, pedagogun që zhvillon lëndën, formën, kohën e vlerësimit dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit dhe literaturën përkatëse. Programi ka rregullore për praktikën profesionale ku përfshihen tematika dhe udhëzime lidhur me realizimin e saj, numri i orëve të praktikës profesionale dhe ETC përkatëse. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se: - GVJ nga verifikimi i dokumentacioni konstatoi se ka lëndë që titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor dhe leksionet zhvillohen nga pedagogë Msc. Bazuar në legjislacionin mbi arsimin e lartë lektorët duhet të jenë të kategorisë doktorë shkencash.

	<u>Për sa më sipër GVJ rekomandon:</u> <i>Titullatët e lëndëve të përzgjidhen nga kategoria profesor.</i> <i>Bazuar në legjislacionin mbi arsimin e lartë lektorët duhet të jenë të kategorisë doktorë shkencash.</i> <i>[Ev. A.3.9 Syllabuse 2022-2023; 2023-2024, Aneks Tabela]</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.	Programi i studimit është në përmirësim të vazhdueshëm bazuar në legjislacionin në fuqi. Ai është riorganizuar sipas rekomandimeve të BA Nr. 56, datë 09.09.2022 dhe VKM nr.185 datë 25.03.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.1.2018 dhe ndryshimet janë në masën 20%. Programi i studimit ishte: A. Lëndë bazë: ska B. Lëndë karakterizuese: 60 ETC C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese: 24 ETC. D. Lëndë plotësuese: 36 ETC E. Detyrime përmbyllës: ska Pas riorganizimit programi i studimit bëhet: A. Lendet bazë 10%(VKM 10-15%) B. Lëndët karakterizuese 55%(VKM 45-55%) C. Lëndë ndërdisiplinore /integruese 10% (VKM 5-15%) D. Lëndë plotësuese 20% (VKM 10-15%) E. Detyrime përmbyllëse 3-5% Riorganizimi i programit mësimor është bazuar në kurikula të ngjashme me vendet e BE, si kurikula Italiane “ Poplo Didactiko Corso operatorio Socio sanitario” nga Azidenca di Pescara 2021. Ndryshimet e bëra në program janë: 1. Shtimi i detyrimeve përmbyllëse dhe lëndëve bazë në program; 2. Futja e 3(tre) lëndëve të reja si : asistencë e pacientëve me crregullime nervore, asistencë e pacientëve në fazën terminale të jetës dhe terminologjia mjekësore; 3. Përmirësimi i titujve të lëndëve:

	- Lëndimet madhore në Mjekësi Urgjence, Lëndime madhore, -Etika dhe komunikimi në Etika dhe Deontologjia në punë -Pataologjitë,vaksinimi dhe ndihma e parë në Kujdesi për vaksinimet dhe komplikacionet; Këto lëndë ofrohen nga pedagogë me tituj dhe gradë shkencore në përputhje me ekspertizën që ofrojnë . Këto ndryshime janë të miratuara dhe arkivuar në departament. [Ev. A.3.7.1 Plani mesimor OKPSH 2022. Evidenca A.3.3 Rregullorja e programit të studimit, Ev.A.3.7.2 Plani mesimor ndryshuar 20%, takime me stafin drejtues dhe akademik]			
Konkluzione	-Departamenti disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi nga pedagogu i çdo lënde si dhe sekretaria mësimore.. -Programi i studimit është riorganizuar sipas rekomandimeve të BA Nr. 56, datë 09.09.2022 dhe përmban të gjitha elementët e organizimit në VKM nr.185 datë 25.03.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.1.2018. Ndryshimet janë në masën 20%. Riorganizmi i programit mësimor është bazuar në kurikula të ngjashme me vendet e BE, si kurikula Italiane " Poplo Didactiko Corso -Institucioni ka informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit. Ka lëndë që titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor dhe leksionet zhvillohen nga pedagogë Msc. Bazuar në legjislacionin mbi arsimin e lartë lektorët duhet të jenë të kategorisë doktorë shkencash. <u>GVJ rekomandon</u> Titullatët e lëndëve të përzgjidhen nga kategoria profesor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit-	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.	Programi i studimit profesional OKPSH është i organizuar me kohë të plotë në dy vite akademike të ndarë në katër semestra në total 120 ECTS (ose 60 ECTS në vit) nga të cilat 24 ECTS i përkasin praktikës profesionale. Në total në të dy vitet akademike programi mësimor realizon 3240 orë mësimore nga të cilat 1260 orë realizohen në auditor. <i>[Ev. A.3.7.1 Plani mesimor OKPSH 2022. Evidenca A.3.3 Rregullorja e programit të studimit, Ev.A.3.7.2 Plani mesimor ndryshuar 20%, takime me stafin drejtues dhe akademik]</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre teorike dhe praktike në fushën e shkencave mjekësore, sociale, menaxhim të proceseve të punës, zgjidhjen e probleme të vecanta të pacientit dhe përshtatjen e tyre në tregun e punës. Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/orë mësimore përputhet me profilin e programit të studimit. <i>[Ev.A.3.3 Rregullorja e programit të studimit, plani mësimor]</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimi në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit është organizuar në leksione, seminare, ushtrime/laboratore dhe praktika profesionale me ngarkesën përkatëse në kredite konvertuar në orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit/ punë të pavarur të studentit. Nga shqyrtimi i programit dhe planit mësimor GVJ konstaton shpërndarje promovionale të ETC midis lëndëve bazë, lëndëve specifike, lëndëve integruese dhe praktikës profesionale, ku raporti teori praktikë është 63: 37. Një vënd të rëndësishëm në programin e studimit profesional për aftësimi praktik të studentëve zë praktika profesionale e cila përbën 30% të orëve të programit mësimorë ose 24 ETC. <i>[Ev. A.3.7.1 Plani mesimor OKPSH 2022]</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe	Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore ore/ETCS ju mundëson studentëve

raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	arritjen e objektivave të programi, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme profesionale. Me njohuritë e mara në këtë program studentët e ndjejnë veten të aftë për ushtrimin e profesionit të tyre dhe përshtatjen me tregun e punës. <i>[Ev. A.3.7.1 Plani mesimor OKPSH 2022], Ev. A.3.9 Syllabuse 2022-2023, takimi me stafin akademik dhe studentë].</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.	Programet e lëndëve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për fitimin e njohurive dhe kompetencës në fushën e shkencave mjekësore, sociale, menaxhim të proceseve të punës, zgjidhjen e probleme të vecanta të pacientit dhe përshtatjen e tyre në tregun punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse. <i>[takimi me stafin akademik dhe drejtues, Ev.A.3.7.2 Plani mesimor ndryshuar 20%, takime me stafin drejtues dhe akademik]</i>
Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	Institucioni i kushton një rëndësi të veçantë bashkëpunimit me institucione apo organizata të ndryshme të cilat i shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale dhe krijimin e kontaktetëve të studentëve me drejtuesit e këtyre institucioneve apo organizatave për punësimin e tyre. Këtij qëllimi i shërben dhe ngritja e bordit të karrierës, pranë këtij program studim dhe krijimin e kontaktetëve të studentëve me drejtuesit e këtyre institucioneve apo organizatave për punësimin e tyre i cili shërben marrjes së mendimit të biznesit për përmirësimin e programit të studimit, nevojat e tregut të punës. Bashkëpunimi dhe vlerësimi i përbashkët i studentit për praktikën profesionale i shërbejnë formimit dhe aftësimin të tij praktik në përputhje me kërkesat e profesionit dhe tregut të punës. <i>[Ev A.3.3 regullorja e programit të studimit, Ev. A.3.6. Paketa e praktikës se programeve me karakter profesiona].</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me	Tematikat që trajtohen në programin e studimit i shërbejnë formimit profesional të studentëve në një fushë profesionale mjet specifike në “Operatorë dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” ku dijet në shkencat mjekësore ndërthuren me ato të shkencave sociale duke ju përgjigjur në këtë mënyrë kërkesave të tregut të punës.Zhvillimi i programit mesimor,

pritsmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.	shpërndarja e ngarkesës mësimore ore/ETCS, zhvillimi i orëve laboratorike dhe praktikës profesionale ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programi, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme për ushtrimin e profesionit të tyre. Institucioni, u ka ofruar mundësi studentëve për trajnime apo marrje pjesë në aktivitete të ndryshme ekstrakurrikulare , që janë në funksion të formimit të tyre profesional. <i>[Ev. A.2.11.b Aktivitete ekstrakurrikulare FSHSKS]</i>			
Konkluzione	<i>-Programi i studimit profesional OKPSH është i organizuar me kohë të plotë në dy vite akademik të ndarë në katër semestra në total 120 ECTS (ose 60 ECTS në vit) nga të cilat 24 ECTS i përkasin praktikës profesionale.</i> <i>- Programi dhe plani mësimor ka shpërndarje promociionale të ETC midis lëndëve bazë, lëndëve specifike, lëndëve integruese dhe praktikës profesionale, ku raporti teori praktikë është 63: 37.</i> <i>- Për aftësimi praktik të studentëve një vënd të rrendesishëm në programin e studimit profesional zë praktika profesinale e cila përbën 30% të orëve të programit mësimorë ose 24 ETC.</i> <i>- Tematikat që trajtohen në programin e studimit i shërbejnë formimit profesional të studentëve në një fushë profesionale mjet specifike në "Operatorë dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore" ku dijet në shkencat mjekësore ndërthuren me ato të shkencave sociale duke ju përgjigjur në këtë mënyrë kërkesave të tregut të punës.</i> <i>- Institucioni i kushton një rëndësi të veçantë bashkëpunimit me institucione apo organizata të ndryshme të cilat i shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale dhe krijimin e kontaktetëve të studentëve me drejtuesit e këtyre institucioneve.</i> <i>-Pike e forte e programit të studimit është bordi i karrierës i cili ndihmon ne krijimin e kontaktetëve të studentëve me drejtuesit e këtyre institucioneve apo organizatave për punësimin e tyre si dhe bashkëpunimin me biznesin për përmirësimin e programit të studimit, nevojat e tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Departamenti çdo fillim viti akademik bën përditësimin e programit të studimit dhe për përshtatjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. Në këtë proces një vend të rëndësishëm zënë dhe informacionet e marra gjatë takimeve me përfaqësues nga institucione të tjera të IAL me profil mjekësor në vendin tonë, përfaqësues të biznesit, studentët e diplomuar <i>[Ev.A.3.5 Marreveshjet e bashkepunimit Ev. A. 3.2. Misioni dhe Studimi i tregut të punës për OKPSH; Takimi me stafin akademik.]</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Pjesë e rishikimit apo përditësimit të programit mësimor janë dhe propozimet e bëra nga studentët që janë në process studimi apo ata që kanë përfunduar studimet dhe janë punësuar në struktura të ndryshme. Mbështetja e studentëve dhe përfshirja e tyre në përmirësimin e programeve realizohet me anë të përfshirjes së studentëve në bordin e administrimit, këshilli studentor, senatin akademik. Institucioni ka një databazë për studentët që ndjekin studimet në programet e studimit si dhe për studentët e diplomuar prej të cilëve merr dhe informacion për kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë në punësimin e studentëve. <i>[Takimi me studentët dhe stafin akademik.]</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e	Çdo vit akademik njësia bazë ku zhvillohet ky program studimi bën rishikim, përditësim të kurikulave. Një vend të rëndësishëm në këtë proces zënë shkëmbimet e ekseperiencave me programe të njëjta të stafit akademik dhe studentëve, organizimet e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar nga fusha e biznesit apo urdhërat profesionale në fushën e shëndetit. <i>[Takime me stafin akademik Ev. A.2.11.b Aktivitete ekstrakurrikulare FSHSKS]</i>

private.				
Konkluzione	Departamenti çdo fillim viti akademik bën përditësimin e programit të studimit dhe përshtatjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. Në bashkëpunim me institucione të tjera të IAL me profil mjekësor në vendin tonë, përfaqësues të biznesit, studentët e diplomuar. Mbështetja e studentëve dhe përfshirja e tyre në përmirësimin e programeve realizohet me anë të përfshirjes së studentëve në bordin e administrimit, këshilli studentor, senatin akademik. Një vend të rëndësishëm në këtë proces zënë shkëmbimet e ekseperiencave me programe të njëjta të stafit akademik dhe studentëve, organizimet e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar nga fusha e biznesit apo urdhërat profesionale në fushën e shëndetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet,	Për zhvillimin e procesit mësimor institucioni/programi studimit ka parashikuar përdorimin e metodave të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, laboratore, detyra kursi, prezantime, projekte, praktika profesionale. GVJ në takimin me stafin akademik konstatoi se në program të studimit zbatohen metoda inovative, platforma dhe sisteme që ndërthurin metodikën standarde të mësimdhënies me komunikimin on line. Ky komunikim i vendosur që gjatë

respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	PAK. Ka një qëndrueshmëri të stafit në dy vitet e fundit. Në takimin me stafin u informuam se në mësimdhënie përdoren metoda alternative si prezantime në ppt., biseda interaktive me studentët apo prezantimi i temave të veçanta nga studentët dhe diskutimi i tyre. Stafi akademik është bashkëpunues dhe mbështetës si në pjesën teorike të zhvilluar në auditor ashtu dhe në zhvillimin e trajnimit praktik në qendrat me të cilat UBa ka marrëveshje bashkëpunimi. Një rol të rëndësishëm në organizimin e procesit mësimdhënës luan dhe koordinatori i departamentit. Për t'iu përgjigjur kërkesave të kohës, stafi është përfshirë në trajnime, konferenca, aktivitete on-line për shkëmbime eksperiencash etj. në funksion të promovimit të metodologjive bashkëkohore në mësimdhënie në përputhje me tipologjinë e programit mësimor. <i>[Evidencat A.2.11.b Aktivitete ekstrakurrikulare FSHM, A.3.9 Syllabuset, Takimet me stafin dhe studentët në institucion]</i>																				
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesmarrje në konferenca shkencore, aktivitete trainuese, për publikime etj. Institucioni ka të siguruar logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, praktikave, aktivitetin kërkimor të studentëve etj. Institucioni ka përgatitur një paketë dokumentash dhe praktikash për realizimin e mësimdhënies, për përdorimin e teknologjisë dhe politikat e publikimit. <i>[Evidenca A.1.36. Lista e konferencave, trajnimeve dhe ëorkshop-eve Takimet në institucion]</i>																				
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e	Programi profesional OKPSH ofrohet nga Departamenti i Shkencave të sjelljes dhe Shëndetit. Referuar tabelës 2 të RVB, në mësimdhënien e programit profesional OKPSH janë angazhuar në mësimdhënie personel PAE dhe PAK siç përshkruhet në tabelën më poshtë. Stafi akademik efektiv realizon 98% të ngarkesës mësimore. Referuar CV të personelit akademik rezulton se stafi akademik i departamentit ka kualifikim, kompetencë dhe eksperiencë në mësimdhënie. <table><tr><th></th><th colspan="2">2022 – 2023</th><th colspan="2">2023 – 2024</th></tr><tr><th>Kategoria</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Profesor</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr. Shk.</td><td>4</td><td></td><td>5</td><td></td></tr></table>		2022 – 2023		2023 – 2024		Kategoria	PAE	PAK	PAE	PAK	Profesor	1	1	1	1	Dr. Shk.	4		5	
	2022 – 2023		2023 – 2024																		
Kategoria	PAE	PAK	PAE	PAK																	
Profesor	1	1	1	1																	
Dr. Shk.	4		5																		

marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Msc.	2	1	1	1
	Gjithsej	7	2	7	2

Përpilimi i syllabuseve dhe mësimdhënia e lëndëve të profilit mjekësor garantohet nga personel akademik i Fakultetit të Shkencave Mjekësore.

GVJ nga verifikimi i dokumentacioni konstatoi se ka lëndë që titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor dhe leksionet zhvillohen nga pedagogë Msc. Në takimin me dekanin dhe Shefin e Departamentit u diskutua kjo mangësi e cila prej tyre u justifikua me faktin se Diploma Msc. është 2 shkallë më lart se diploma Profesionale. Ligji i arsimit të Lartë, neni 59 pika 6 thekson se personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Në kolegjet profesionale të larta, personeli akademik duhet të ketë fituar së paku diplomën “Master profesional”.

[Evidenca A.3.8. CV Stafit Akademik, A.3.9 Syllabuset, Tabelat e RVB, Takimi me Dekanin dhe Shefin e Departamentit]

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësori të vlerësimit. Anketimi i studentëve organizohet nga Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shendetit në bashkëpunim me Njësinë e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Rezultatet e pyetsorëve përdoren nga njësia kryesore për hartimin e politikave të përmirësimit. Në takimin me studentët ata u shprehën se shpjegimi është i qartë dhe reflekton përdorimin e metodave inovative. Në orën e mësimi ka bashkëveprim interaktiv pedagog-student. Institucioni mbështet dhe inkurajon bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjelltë pedagog-student që reflektohet dhe në realizimin e konferencave studentore. <i>[Evidenca A.1.11. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën, Takimi me studentët në institucion]</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të	Institucioni ka 2 struktura që koordinojnë dhe bashkëveprojnë me njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. 1. Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, organ kolegjal i përhershëm që siguron orientim, këshillim,

mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	mbështetje në hartimin e politikave dhe procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. 2. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, njësi autonome në nivel institucioni që monitoron; vlerëson, zhvillon dhe përmirëson cilësinë e veprimtarisë së UniBa. Njësia e zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë pregatit raporte vjetore që i ve në dispozicion të njësive kryesore/bazë. Këto raporte ndihmojnë në evidentimin e problematikave dhe përmirësimin e vazhdueshëm. UniBa mbështet dhe nxit zhvillimin profesional dhe kualifikimin shkencor të personelit akademik. Në institucion janë zhvilluar trajnime për stafin akademik. Në takimet me stafin akademik u konstatua fryma positive e institucionit në raport me bashkëveprimin hierarkik dhe horizontal në nivel njësie qëndrore dhe njësie bazë. Në takimin me zyrën e marrëdhënieve ndërkombëtare u informuam se pedagogët janë të përfshirë në programin e mobilitetit Erasmus+ përmes të cilit fitojnë eksperiencë në mësimdhënie dhe në fusha të kërkimit shkencor. Institucioni gjithashtu është përfshirë në programin RID që i krijon stafit mundësi komunikimi me akademikë të diasporës që kontribuojnë për ngritjen e kapaciteteve shkencore në institucion. UniBa organizon një konferencë shkencore vjetore të listuar në Scopus (publikimet e konferencës) dhe përmes bashkëpunimit me shtëpi botuese ka krijuar lehtësira për publikimin e monografive nga pedagogët. <i>[Evidencat A.1.9. Rregullore e NJZHKC, A.1.19. Rregullore e komisionit të sigurimit të standardeve të cilësisë, A.1.29. Raport për vlerësimin dhe cilësinë, Takimet në institucion]</i>
Konkluzione	<i>Institucioni garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në përgjithësi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencë pedagogjike në lëndët që zhvillon.</i> <i>GVJ nga verifikimi i dokumentacioni konstatoi se ka lëndë që titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor</i> <i>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të</i>

	tyre ne funksion të formimit profesional teorik të studentëve. Institucioni ka ngritur struktura që koordinojnë dhe bashkëveprojnë me njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Institucioni mbështet dhe promovon aktivitetin shkencor të stafit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Në rregulloren e programit të studimit, në syllabuse dhe planin mësimor shkruhen qartë kriteret dhe procedurat e vlerësimit, detyrimet që duhet të përmbushen për të hyrë në provim, mënyra e zhvillimit të provimit dhe të dhënat mbi dokumentimin e vlerësimit (procedura e ankimimit dhe rivlerësimit). Në takimin me studentët GVJ diskutoi dhe mbi mënyrën e informimit për vlerësimin në provime me email apo përmes sistmit të brendshëm të informacionit. [Evidencat A.1.3. Rregullore e UniBa, A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH, A.3.9 Syllabuse 2022-2023; 2023-2024, takimi me studentët]
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në syllabuset e lëndëve/ moduleve të përgatitura nga titullari i lëndës shkruhet qartë metodologjia e vlerësimit të njohurive. Studentët informohen që në fillim për kushtet e frekuentimit, detyrimet për t'u plotësuar dhe kriteret e vlerësimit. Në rregulloren e programit të studimit theksohet se vlerësimi i dijeve bëhet sipas: – Sistemit me notë: nga 1 – 10 (nota kaluese 5/ vlerësimi maksimal 10) – Sistemit me pikë: 1 – 100 (nota kaluese >50/ vlerësimi

	maksimal 96 – 100) – Sistemi me shkronjë: A – F (vlerësimi maksimal A; vlerësimi jokalues F) Në programin mësimor të “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” një vend të rëndësishëm zë dhe praktika për përfitimin e aftësive profesionale. Institucioni ka përgatitur “Paketën e praktikës” në të cilën detajohet procedura e vlerësimit të studentit në të gjithë komponentët e saj duke filluar nga frekuentimi, cilësitë etike dhe aftësitë e ndryshme profesionale (sipas lëndëve). <i>[Evidencat A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH, A.3.6 Paketa e praktikës profesionale, A.3.9 Syllabuse 2022-2023; 2023-2024, Takimi me studentët]</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.	Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare/ praktika, provimi diplomimit. Në syllabuse përcaktohen komponentët e vlerësimit dhe pesha specifike e tyre: – provimi i ndërmjetëm 20% – pjesmarrja, aktivizim dhe detyrat e kursit 30% – provimi përfundimtar 50% Vlerësimi i vazhdueshëm i jep mundësi studentit të demonstrojë më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Procedura e testimit të njohurive mbështetet në Rregulloret e institucionit dhe specifikisht në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i dijeve bëhet në përputhje me planin e studimit dhe zhvillohet në tre sezona: sezoni dimrit, verës, vjeshtës. <i>[Evidencat A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH, A.3.6 Paketa e praktikës profesionale, A.3.9 Syllabuse 2022-2023; 2023-2024, Takimi me studentët]</i>
Konkluzione	Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Studentët informohen në fillim të vitit akademik nga titullari i lëndës/modulit mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e

	shkencore. Informacioni i detajuar gjendet në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. që realizohet me anë të provime, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare, praktika, provimi diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Në rregulloren e programit të studimit, në tabelat e RVB dhe syllabuse përcaktohet se: – 30% e pikëve të notës fitohen nga ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive dhe detyrat e kursit (ka variabilitet midis komponentëve në syllabuse të ndryshme) – 20% e pikëve të notës fitohen nga testimet e kryer gjatë vitit – 50% e pikëve të notës fitohen nga provimi përfundimtar <i>GVJ konstaton mospërputhje të këtyre të dhënave me të dhënat e tabelës 15 të RVB.</i> Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, dhe në bazë të rregullore së programit të studimit numri i pikëve i referohet notës përkatëse. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari lëndës/pedagogu. Nota minimale kaluese është nota 5 për të cilën duhen akumuluar të paktën 50 pikë. Nota maksimale është nota 10 që merret kur studenti akumulon 95 – 100 pikë. Megjithë akumulimin e pikëve vjetore, provimi përfundimtar është i detyrueshëm. <i>[Evidencat A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH, A.3.9 Syllabuse 2022-2023; 2023-2024]</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të	Metoda e përdorur është testimi me shkrim me sekretim të të dhënave të studentit nga përfaqësuesit e sekretarisë mësimore, me qëllim ruajtjen e anonimatit të studentit.

cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Pasqyrimi i vlerësimit të studentit kryhet nëpërmjet portalit studentor, sistem që iu mundëson studentëve informimin në kohë reale për rezultatet akademike, informacione për lektorët etj. UniBa ka ngritur sisteme të koordinuara për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe të dhënave të tjera akademike e administrative. Gjatë periudhës së pandemisë Covid19, personeli akademik u trajnuar për të përdorur gjerësisht platformat elektronike për mësimdhënie dhe vlerësim të studentëve. <i>[Evidenca A.1.34. Udhëzues për përdorimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, Tabela 17 e RVB, takimet në institucion]</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim nga një komision i përbërë nga pedagogët e lëndës. Kur lënda zhvillohet nga një pedagog, komisioni përbëhet vetëm prej tij. <i>GVJ rekomandoi që në çdo rast komisioni i provimit të përbëhet nga të paktën 2 pedagogë.</i> Teza e provimit hartohet nga pedagogu që ka zhvilluar leksionet, kontrollon nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Në përfundim të procesit mësimor pedagogu i lëndës i komunikon studentit fitimin ose jo të mundësisë për të hyrë në provim (bazuar në informacionin e sekretarisë mësimore për frekuentimin dhe pagesat) dhe rezultatin e vlerësimit të vazhduar. Procesverbali i provimit gjenerohet nga sistemi dhe firmoset nga pedagogët që kanë realizuar provimin. Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi e sekretarisë dhe komisionit të provimit. <i>[Evidenca A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH, takimi me sekretarinë mësimore]</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e procesit mësimor për çdo lëndë dhe detyrimet financiare sipas kontratës që ka me institucionin. Rregullorja e programit të studimit përcakton ECTS teoriko-praktike dhe llojin e lëndëve që studenti duhet të ketë të plotësuar para futjes në një sezon provimi. Studenti ka të drejtë të shohë rezultatet e provimit të cilat komentohen nga pedagogu. Studenti ka të drejtë të ankimojë rezultatin e provimit. <i>[Evidencat A.1.3 Rregullore e UniBa, A.3.3. Rregullore e</i>

	<i>programit profesional OKPSH]</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	UGJ ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime. Në institucion funksionon Kodi i Etikës që plagjiaturën e konsideron sjellje të ndaluar. Në rregulloren e studimeve në kodin e etikës dhe në fund të çdo syllabusi rastet e kopjimit apo plagjiaturës konsiderohen të ndaluara. Stafi akademik i departamentit organizon dhe monitoron zhvillimin e provimit duke respektuar rregulla strikte për moslejimin e kopjimit. <i>[Evidencat A.1.5. Kodi i Etikës, A.3.9 Syllabuse 2022-2023; 2023-2024]</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Procedura e dhënies së rezultateve të kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohet në rregulloren e UniBa. Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit i garanton studentëve vlerësimin bazuar në meritë. Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset kanë të detajuar procedurën e vlerësimit (përkthyer në kriterin 1 të këtij standardi). Rregullorja përcakton se provimet mund të bëhen me shkrim, me gojë ose të kombinuara. Në programin e studimit profesional OKPSH, është praktikuar provimi me shkrim me pyetje shtjelluese dhe/ose ushtrime me alternativa. Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve brenda 6 ditëve pas zhvillimit të provimit. Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve. <i>[Evidencat A.1.3 Rregullore e UniBa, A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH, A.3.9 Syllabuse 2022-2023; 2023-2024]</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin para se vlerësimi të marrë formë përfundimtare. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Këto rregullore i japin të drejtë studentit të njihet me vlerësimin, të ankimohet për vlerësimin, të mund të përmirësojë notën përmes riprovimit. <i>[Evidencat A.1.3 Rregullore e UniBa, A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH]</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë,	Nëse studenti nuk është dakord me rezultatin e provimit dhe

ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	sqarimin nga pedagogu, i paraqet ankesë me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit. Nëse pas verifikimit prej tij, kërkesa nuk gjen zgjidhje, përgjegjësi i departamentit informon dekanin. Dekani brenda 48 orëve ngrë një komision ad-hoc dhe bën verifikimet përkatëse. Komisioni mund të vendosë të lërë në fuqi vlerësimin aktual, të ndryshojë vlerësimin ose të urdhërojë përsëritjen e provimit me një komision tjetër. E gjithë procedura e ankesës dhe rivlerësimi të studentit dokumentohet dhe arkivohet në institucion pranë Sekretarisë Mësimore. <i>[Evidencat A.1.3 Rregullore e UniBa, A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH, takimet në institucion]</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve. Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim. Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Vlerësimi bazohet në meritë. UniBa ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” që ofrohet nga Departamenti i Shkencave të sjelljes dhe shëndetit në UBa përgatit specialistë për një fushë specifike të shërbimit mjekësor-komunitar për të cilën tregu ka shumë nevojë. Ky program ofrohet vetëm nga UBa. Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe

	zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e shërbimit ndihmës infermieror për t'iu përgjigjur kërkesave të shoqërisë shqiptare në kontekstin e zhvillimeve bashkëkohore, përfshi shtimin e nevojës për operatorë dhe këshillues të përkujdesit shëndetësor në sistemin spitalor por dhe shtimin e nevojave për shërbim asistencë dhe ndihmës infermierë në sistemin ambulator në kontekstin e moshimit të popullsisë dhe shkallës së lartë të emigracionit. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. Programi i studimit është riorganizuar sipas rekomandimeve të BA Nr. 56, datë 09.09.2022 dhe përmban të gjitha elementët e organizimit në VKM nr.185 datë 25.03.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.1.2018. Ndryshimet janë në masën 20%. Pas riorganizimit programi i studimit përmban: F. Lëndë bazë 10% (VKM 10-15%) G. Lëndë karakterizuese 55% (VKM 45-55%) H. Lëndë ndërdisiplinore /integruese 10% (VKM 5-15%) I. Lëndë plotësuese 20% (VKM 10-15%) J. Detyrime përmbyllëse 5% (3-5%) Përmirësimi i strukturës së programit të studimit është shoqëruar dhe me modifikime deri 20% të emërtimeve dhe syllabuseve të lëndëve për t'i përafëruar me programe të ngjashme europiane në funksion të aftësimit specifik profesional të studentëve. <i>[Evidencat RVB, Tabelat e RVB, A.3.9 Syllabuse 2022-2023; 2023-2024]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë dhe karakterizuese që japin informacion të përgjithshëm (anatomia) apo specifik profesional për kujdesin në situata të urgjencës, në grupmosha të ndryshme, për rehabilitimin etj., përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshëm si gjuha e huaj, informatikë-statistikë, menaxhim i proçeseve të punës etj. Përmes këtyre lëndëve synohet zhvillimi i aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit. Praktika profesionale e zhvilluar në subjekte publike apo private krijon premisë për shtimin e aftësive komunikuese dhe ndërvepruese. <i>[Evidencat A.3.7-2 Plani mësimor OKPSH i ndryshuar 20%,</i>

	<i>A.3.9 Syllabusët, A.3.5 Marrëveshjet e bashkëpunimit]</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabusët e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Syllabusët e lëndëve përcaktojnë kompetencat dhe aftësitë që duhet të ketë studenti në përfundim të ciklit mësimor të lëndës përkatëse. Në përfundim të lëndës, në orën e fundit të mësimit pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme, si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Pedagogu ndalet në veçanti në temat që janë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të tyre. Në fund të praktikës profesionale pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale të fituara nga studentët. Provimet dhe format e tjera të testimit si dhe plotësimi i detyrimeve përmbyllëse pasqyrojnë shkallën e përfitimit të njohurive dhe analizohen në fund të vitit në mbledhjet e stafit akademik. <i>[Evidenca A.3.9 Syllabusët, takimet me studentët dhe stafin akademik]</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Në programin profesional OPKSH janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie në lëndët mjekësore dhe me karakter psiko social. Programi i studimit ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin e misionit dhe për t'u përballur me kërkesat e tregut të punës për ndihmën dhe asistencën e individëve pacientë apo grupeve në nevojë. Gjithashtu gjatë programit të studimit studentët fitojnë njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe ndërveprimit. Programi i studimit është specifik dhe bazohet në punën individuale të studentit dhe mësimin në auditor. Gjatë realizimit të procesit mësimor stafi akademik mbështet punën në grup të studentëve, diskutimet e rasteve klinike në seminare, praktika mësimore dhe veçanërisht ato profesionale. Institucioni inkurajon studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme duke ju vënë në dispozicion laboratorët, bibliotekën e Universitetit apo sallat e kompjuteravë dhe asistencën nga stafi akademik. Studentët inkurajohen të marrin pjesë në në aktivitetet që organizon departamenti, temave të kursit, projekte të ndryshme mobiliteti apo projekte komunitare. Në takimin me stafin akademik u informuam se nga ky program studimi nuk ka ende studentë të aktivizuar ne

	aktivitetet e mësipërme. <i>[Evidenca A.3.9 Syllabuset, takimet me studentët dhe stafin akademik]</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në funksion të një pregatitje të gjithanshme profesionale dhe të formimit të mendimit kritik, institucioni organizon në mënyrë periodike leksione të hapura apo konferenca shkencore me pjesmarrjen e personaliteteve të shquar vendas apo të huaj. Në këto aktivitete krahas lektorëve të ftuar përfshihen dhe lektorë nga stafi akademik i UBa. <i>[Evidenca A.3.9 Syllabuset, takimet me studentët dhe stafin akademik]</i>			
Konkluzione	Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e shërbimit ndihmës infermieror për t'iu përgjigjur kërkesave të shoqërisë shqiptare në kontekstin e zhvillimeve bashkëkohore, përfshi shtimin e nevojës për operatorë dhe këshillues të përkujdesit shëndetësor në sistemin spitalor por dhe shtimin e nevojave për shërbim asistencë dhe ndihmës infermiere në sistemin ambulator në kontekstin e moshimit të popullsisë dhe shkallës së lartë të emigracionit. Struktura e programit të studimit është përmirësuar pas riorganizimit. 65% të programit e zenë lëndët e formimit bazë dhe karakterizuese. dhe lëndë të formimit të përgjithshëm si gjuha e huaj, informatikë, terminologji mjekësore, menaxhimi, etikë. Përmes këtyre lëndëve synohet zhvillimi i aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit. Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme. Në funksion të një pregatitje të gjithanshme profesionale dhe të formimit të mendimit kritik, institucioni organizon në mënyrë periodike leksione të hapura apo konferenca shkencore me pjesmarrjen e personaliteteve të shquar vendas apo të huaj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Studentit në fund të studimeve i lind e drejta të pajiset me diplomë profesionale në “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur provimin përfundimtar. Prova finale në këtë program studimi realizohet në formën e provimit përfundimtar. Proçedura për detyrimet përmbyllëse hartohet bazuar në Rregulloren e UniBa (kapitulli VIII) dhe në Rregulloren e programit të studimit. Rregullorja e UniBa e njeh studentin me kushtet e diplomimit për të gjitha programet mësimore (detyrimet që duhet të përmbushë studenti), pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome (pragu është nota 8 ose një kufi më i lartë i vendosur nga njësia bazë), rregullat për përgatitjen dhe mbrojtjen e punimit të diplomës, rregullat për përgatitjen dhe realizimin e provimit të formimit. Rregullat globale të përcaktuara në këtë rregullore pasqyrohen dhe në rregulloret e tjera institucionale dhe në rregulloren e programit të studimit. Studentët njihen me proçedurën dhe në takimet informuese të realizuara nga departamenti. <i>[Evidencat A.1.3 Rregullore e UniBa, A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH]</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Fokusi kryesor i programit profesional OKPSH është përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit. Bazuar në këtë qëllim provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit në provimin përfundimtar. Në fillim të vitit të fundit të studimeve, pedagogët e Departamentit i orientojnë studentët dhe iu japin informacion lidhur me temat apo materialet që duhet të konsultohen për provimin final. <i>[Evidencat A.1.3 Rregullore e UniBa, A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH, Takimet me stafin dhe studentët]</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke	Programi dy vjeçar profesional OKPSH finalizohet me Provim përfundimtar. Testimi bazohet në njohuritë e marra gjatë programit të studimit. Teza e provimit përmban pyetje nga të gjitha fushat që përfshihen në programin e studimit. Komisioni i ngritur me propozim të departamentit përgatit tezën përfundimtare e cila firmoset dhe aprovohet nga

përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Përgjegjësi i departamentit. Provimi përfundimtar i formimit mund të zhvillohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Mënyra e organizimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar përcaktohet në rregulloren e programit të studimit. <i>[Evidencat A.1.3 Rregullore e UniBa, A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH, Takimet me stafin dhe studentët]</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Kriteri nuk aplikohet në këtë program studimi.
Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	Praktika profesionale përbën një komponent të rëndësishëm të programit profesional OKPSH. Ajo realizohet në institucione publike apo private me të cilat UniBa ka marrëveshje bashkëpunimi. Pedagogu mbikqyrës i praktikës profesionale udhëzon studentët dhe monitoron kryerjen e praktikës nga studentët. Pedagogu mbikqyrës orienton studentët dhe për mënyrën e mbledhjes së të dhënave, analizimin e tyre në funksion të temave të trajtuara si detyra kursi. <i>[Evidencat A.3.6 Paketa e praktikës për programet profesionale, A.3.5 Marrëveshjet e bashkëpunimit, Tabela 5 e RVB]</i>
Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi përfundimtar i provimit të diplomimit bëhet me notë. Teza korrigjohet nga komisioni vlerësimit. Proçes verbali përfundimtar firmoset nga anëtarët e komisionit dhe dorëzohet në sekretari. Në Rregulloren e UniBa dhe Rregulloren e programit të studimit përcaktohen kufijtë e vlerësimit sipas:

	– Sistemit me notë: nga 1 – 10 (nota kaluese 5/ vlerësimi maksimal 10) – Sistemit me pikë: 1 – 100 (nota kaluese >50/ vlerësimi maksimal 96 – 100) – Sistemit me shkronjë: A – F (vlerësimi maksimal A; vlerësimi jokalues F) Rregullorja e programit të studimit përcakton gjithashtu sezonet për provimin përfundimtar (i verës dhe i dimrit), modalitetet për riprovimin në rast moskalimi në sezonin e parë dhe procedurën për paisje me dëshmi (jo diplomë) në rastet kur studenti rrëzohet përsëri në riprovim. <i>[Evidencat A.1.3 Rregullore e UniBa, A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH]</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit, studenti pajiset me Diplomë profesionale në “Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore”. Diploma është hartuar sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori. Regjistrimi i Formës së Diplomës nga QSHA është bërë me Urdhërin 225 datë 31.10.2022. Diploma është regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe ka numrin unik të identifikimit MB7235221649. <i>[Evidencat A.3.3. Rregullore e programit profesional OKPSH, A.3.4 Diplomë OKPSH]</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar. Institucioni mund të japë informacion për studentët nëse kërkohet. Në sekretariatë mësimore të fakultetit gjëndet regjistri themeltar i studentëve, regjistri i arritjeve akademike dhe regjistri i tërheqjes së diplomës dhe çertifikatave. Administrimi i dokumentacionit të mësipërm bëhet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Rregulloren e sekretarisë mësimore. GVJ inspektoi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit dhe plotësimin e regjistrave në sekretarinë mësimore dhe i gjeti ato konform ligjit dhe rregulloreve. Procedura e ruajtjes, arkivimit apo asgjëësimit të dokumentacionit parashikohet në Rregulloren e Protokollit

	dhe Arkivës. <i>[Evidencat A.1.21. Rregullore për funksionimin e sekretarisë mësimore, A.1.26. Rregullore e protokollit dhe arkivës]</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin me karakter profesional "Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore" dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë profesionale pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Implementimi dhe përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies më qëllim rritjen e cilësisë akademike është një proces i rëndësishëm në përmirësimin e performancës së institucioneve të arsimit të lartë. UniBa i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të metodave inovative të mësimdhënies me në qëndër studentin duke promovuar mendimin kritik, dialogun student-pedagog dhe përgatitjen e studentëve të aftë për tu përshtatur kërkesave të tregut të punës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe në takimin me stafin GVI konstaton se UniBa ka hartuar dokument për politikën e mësimdhënies dhe cilësisë së saj si dhe udhëzues të mirëfilltë në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies (udhëzues për përdorimin e TIK, për mësimdhënien, për përdorimin e Google classroom). Personeli akademik trajnohet vazhdimisht përmes pjesëmarrjes në projekte të ndryshme, zhvillimit të leksioneve të hapura nga lektorë të ftuar jashtë universitetit, vizitave në kuadër të projekteve të mobilitetit etj.

	[Evidencat A.1.13. Udhëzues për metodat e mësimdhënies, A.1.14. Politika për të mësuarin, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie, A.1.34. Udhëzues për përdorimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa, A.1.36. Lista e konferencave, ëorkshopeve, Takimet në institucion]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë në nivel institucional, në nivel të Fakulteti dhe kordinatorin në nivel programi studimi përgjegjës për cilësinë i cili monitoron e vlerëson periodikisht cilësinë e programit të studimit. Zyra e zhvillimit të kurrikulës dhe cilësisë është ekuivalenti i NJSBCsë. Ajo është përgjegjëse për hartimin dy herë në vit të pyetsorëve përmes të cilëve studentët vlerësojnë lëndën dhe pedagogun. Në takimin me koordinatoren e zyrës GVJ u informua mbi procedurën që ajo ndjek për analizimin e rezultateve të pyetsorëve, hartimin e raportit dhe përcjelljen e raportit në departamente pas miratimit nga Rektori. Në monitorimin e cilësisë një rol të rëndësishëm ka dhe departamenti i cila ka mekanizmat e tij të brendshëm si relacionet e pedagogëve për lëndën etj. [Evidencat A.1.19. Rregullore e komisionit të sigurimit të standardeve të cilësisë, A.1.11. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën, A.1.29. Raport për vlerësimin dhe cilësinë, Takimet në institucion]
Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Përmirësimi i vazhdueshëm i standardeve të cilësisë është kërkesë e Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, Neni 103: “Sigurimi i brendshëm i cilësisë”. Siç u theksua dhe më lart, në UniBa funksionon Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetsorin e studentëve për matjen e performancës në mësimdhënie për çdo lëndë dhe çdo program studimi. Të dhënat publikohen periodikisht me qëllim rritjen e transparencës ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë. Në RVB theksohet se departamenti realizon dhe vlerësim të punës së pedagogut <i>peer to peer</i> (ndërmjet kolegësh). Ky proces monitorohet nga përgjegjësi i departamentit që harton raportin mbështetur në evidencat të cilin ia përcjell Dekanit dhe zyrës së performancës. [Evidencat A.1.10. Formular vlerësimi koleg-koleg, A.1.11.

	<i>Formular vlerësimi i studentëve për lëndën, A.1.29. Raport për vlerësimin dhe cilësinë, Takimet në institucion]</i>			
Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Të dhënat e përpunuara nga pyetorët shërbejnë për promovimin e praktikave të mira dhe nxitjes së stafit akademik për përmirësim të mësimdhënies si dhe përcaktimin e kriterëve dhe afateve për rishikimin e kurrikulave, hartimin e procedurave për përzgjedhjen e tekseve mësimore dhe aplikimin e teknologjisë mësimore, përmirësime të infrastrukturës mësimore etj. <i>[Evidencat A.1.19. Rregullore e komisionit të sigurimit të standardeve të cilësisë, A.1.15. Format i raportimit të punës semestrale]</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë në nivel institucional, në nivel të Fakulteti dhe kordinatorin në nivel programi studimi përgjegjës për cilësinë i cili monitoron e vlerëson periodikisht cilësinë e programit të studimit. Në monitorimin e cilësisë një rol të rëndësishëm ka dhe departamenti i cila ka mekanizmat e tij të brendshëm të kontrollit dhe monitorimit. Të dhënat e përpunuara nga pyetorët shërbejnë për promovimin e praktikave të mira dhe nxitjes së stafit akademik për përmirësim të mësimdhënies si dhe përcaktimin e kriterëve dhe afateve për rishikimin e kurrikulave, hartimin e procedurave për përzgjedhjen e tekseve mësimore dhe aplikimin e teknologjisë mësimore, përmirësime të infrastrukturës mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi																														
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në përgjithësi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencë profesionale apo pedagogjike në lëndët që zhvillon. Hapja e Fakultetit të Shkencave Mjekësore ka siguruar qëndrueshmëri të stafit PAE me profil mjekësor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit si CV e stafit akademik, Planit mësimor, Tabelat 4, 6.1, 6.2 të RVB, GVJ konstatoi se: <i>Ka pedagogë që japin më shumë se tre lëndë të profileve të ndryshme.</i> <i>Ka pedagoge lektorë të kategorisë Msc, kur legjislacioni përcakton që lektorët duhet të zotërojnë gradën “Doktor Shkence”.</i> <i>GVJ rekomandon përshtatjen e ngarkesës sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin 29 të MASR, datë 10/09/2018.</i> Sipas tabelës 2 të RVB personeli akademik përgjegjës për programin e studimit për dy vite akademike paraqitet si më poshtë: <table><tr><th></th><th colspan="2">2022–2023</th><th colspan="2">2023– 2024</th></tr><tr><th>Kategoria</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>2</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Msc</td><td>9</td><td>-</td><td>10</td><td>1</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>12</td><td>1</td><td>12</td><td>2</td></tr></table> Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se ka qëndrueshmëri të stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi. Në takimin me studentët konstatuam se ata janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies, me komunikimin dhe ndërveprimin e pedagogëve në orët e mësimi si dhe me materialet didaktike që pedagogët pregatisin për procesin mësimor.		2022–2023		2023– 2024		Kategoria	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1	-	1	-	Dr./PhD.	2	1	1	1	Msc	9	-	10	1	Gjithsej	12	1	12	2
	2022–2023		2023– 2024																												
Kategoria	PAE	PAK	PAE	PAK																											
Prof.Dr	1	-	1	-																											
Dr./PhD.	2	1	1	1																											
Msc	9	-	10	1																											
Gjithsej	12	1	12	2																											

	<i>[Evidencat A.3.7-2 Plani mësimor OKPSH i ndryshuar 20%, A.3.9 Syllabuset, A.1.8. Formati i dosjes personale të stafit, A.3.8. CV Stafit Akademik, tabelat e RVB, takimet dhe vizita në institucion]</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Në hartimin e ngarkesës mësimore në programin e studimit profesional OKPSH janë bërë ndryshime në masën 20% duke plotësuar rekomandimin e BA dhe që kanë ndikuar pozitivisht në strukturimin e programit. Ngarkesa mësimore e programit të studimit mbulohet nga pedagogët efektivë të departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit, pedagogë efektivë të fakulteteve të tjera të UniBa dhe pedagogë me kontratë. Në tabelat e ngarkesës mësimore të programit rezulton se mbi 80% e ngarkesës (95%) përballohet nga PAE duke respektuar kornizën ligjore në fuqi. <i>[Evidencat A.3.7-2 Plani mësimor OKPSH i ndryshuar 20%, A.3.9 Syllabuset, tabelat e RVB, A.1.16. Udhëzim lidhur me punën për hartimin e ngarkesës mësimore për vitin akademik 22-23]</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Institucioni ka Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore që ka në fokus hartimin e politikave, strategjisë për rekrutimin e një stafi të kualifikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me aktet rregullatore të institucionit. GVJ vizitoi Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ku u njoh me dokumentacionin e personelit të përfshirë në këtë program studimi dhe me procedurat e rekrutimit dhe i gjeti konform kërkesave ligjore në fuqi. Nga të dhënat e RVB dhe syllabuseve konstatohet se në programin e studimit OKPSH ka qëndrueshmëri të stafit akademik në 3 vitet e fundit. <i>[Evidencat A.1.6. Manual i menaxhimit të burimeve njerëzore, tabelat e RVB, takimet në institucion]</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,	Në UniBa është ngritur dhe funksionon sipas rregullores specifike Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (ZMBN) e cila ka në fokus hartimin e politikave dhe strategjisë për rekrutimin e stafit të kualifikuar në funksion të specifikave të programeve të studimit. Në takimet në institucion GVJ u njoh me procedurën konkrete të rekrutimit të stafit akademik. Kërkesa për staf akademik bëhet nga Departamenti. Procedura është transparente. Shpallet vakanca (pozicioni, kriteret, afati i aplikimit) në ëeb. ZMBN mbledh aplikimet

strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	dhe ngre komisionin që seleksionon kandidatët sipas dokumentacionit. Me tej kandidatët thirren për intervistë. Institucioni ka rregullore për vlerësimin e performancës me profesionalizëm dhe objektivitet. <i>[Evidencat A.1.6. Manual i menaxhimit të burimeve njerëzore, A.1.17. Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës, takimet në institucion]</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	UniBa angazhon personel ndihmës akademik me diplomë master i shkencave për menaxhimin dhe asistimin e studentëve në orët praktikave laboratorike dhe mësimore. Në tabelat e RVB-së nuk pasqyrohet numri i personelit ndihmës akademik që angazhohet në mënyrë specifike në programin e studimit me karakter profesional OKPSH. <i>[RVB, tabelat e RVB]</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.	Gjatë vizitës në institucion dhe përmes shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ konstatoi se UniBa disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore”. Të dhënat e plota të stafit akademik gjendet pranë ZMBN në dosjet personale. Institucioni ka vënë në dispozicion të GVJ, listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe ngarkesën e tyre mësimore. Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore të institucionit GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK. GVJ verifikoi dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë. Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore u përzgjedhën dy dosje në mënyrë rastësore, një nga personeli akademik efektiv dhe një me kontratë të cilat rezultuan të kompletuara, konform rregullave dhe kriterëve institucionale. <i>[Evidencat A.1.6. Manual i menaxhimit të burimeve njerëzore, A.1.8. Formati i dosjes personale të stafit, takimet në institucion]</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe	Praktika profesionale është një komponent i rëndësishëm i programit të studimit. Ajo realizohet në institucionet me të

bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	cilat UniBa ka marrëveshje bashkëpunimi. Në funksion të realizimit të praktikës profesionale në OKPSH, UniBa ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione spitalore dhe qendra të kujdesit për moshën e tretë. Institucioni ka siguruar përmes marrëveshjeve jo vetëm akomodimin e studentit por dhe mbikëqyrjen nga personeli pritës. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi dhe me institucione të arsimit të lartë dhe përfaqësues biznesi. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve ka organizuar veprimtari të përbashkëta dhe ka aplikuar në projekte me interes për komunitetin. <i>[Evidenca A.3.13 Marrëveshjet e bashkëpunimit, Tabela 5 e RVB, Takimet në institucion]</i>
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Veç ambjenteve mësimore të kampusit universitar, studentëve iu ofrohet (përmes marrëveshjeve dypalëshe) mundësia e praktikës në sistemin spitalor, në institucione me fokus përkujdesjen ndaj kategorive vulnerabël si dhe në shoqata që asistojnë këto komunitete. Institucioni ka përgatitur "Paketën e praktikës" në të cilën detajohet procedura e vlerësimit të studentit në të gjithë komponentët e saj duke filluar nga frekuentimi, cilësitë etike dhe aftësitë e ndryshme profesionale (sipas lëndëve). Në ndjekjen e aktivitetit të studentit dhe asistimin e tij për realizimin e programit të praktikës përfshihen personel i qëndrave ku zhvillohet praktika. <i>[Evidenca A.1.7. Paketa e praktikës për programet profesionale]</i>
Konkluzione	<i>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në përgjithësi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencë profesionale apo pedagogjike në lëndët që zhvillon.</i> <i>Ka qëndrueshmëri të stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi. mbi 80% e ngarkesës (95%) përballohet nga PAE duke respektuar kornizën ligjore në fuqi.</i> <i>Ka pedagogë që japin më shumë se tre lëndë të profileve të ndryshme. Ka pedagoge lektorë të kategorisë Msc, kur legjislacioni përcakton që lektorët duhet të zotërojnë gradën "Doktor Shkence".</i> <i>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (ZMBN) ka në fokus hartimin e politikave dhe strategjisë për rekrutimin e stafit të kualifikuar në funksion të specifikave të programeve të studimit.</i>

	UniBa disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit "Operator dhe këshillues në përkuqjesje shëndetësore". Në funksion të realizimit të praktikës profesionale në OKPSH, UniBa ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione spitalore dhe qendra të kujdesit për moshën e tretë. Institucioni ka siguruar përmes marrëveshjeve jo vetëm akomodimin e studentit por dhe mbikqyrjen nga personeli pritës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni është i organizuar në formën e 2 Kampuseve Universitare (3 godina). Kampuset janë të vendosura larg zonave industriale dhe janë organizuar në mënyrë të tillë që të krijojë siguri dhe njëkohësisht lirëshmëri lëvizje për studentët. Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor. [Evidenca A.2.13.2. Planimetria, vizita në institucion]
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive	Në RVB dhe dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimore, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyrat për stafin, biblioteka si dhe hapësirat e tjera rekreative. Ambjentet janë me sistem kondicionimi dhe sistem ëireless, nyje hidrosanitare, sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve të cilat u verifikuan dhe gjatë vizitës në institucion. GVJ vizitoi auditorët mësimorë ku sallat e leksioneve ishin të pajisura me video-projektor, kompjuter të lidhur me internet, tabela dhe foni. Të gjitha

bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	sallat mësimore janë të pajisura gjithashtu me mjete audio vizive si PC, projektorë. Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim. [RVB, Evidenca A.2.13.2. Planimetria , tabela 16 e RVB, vizita në institucion]			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në hapësirat e Kampusit 2 laboratorët në funksion të programit të studimit (anatomi, biokimi, infermieri etj.) janë vendosur në një hapësirë që siguron bashkërendim të punës në funksion direkt të zhvillimit të programit mësimor. GVJ vizitoi ambientet e laboratorëve dhe konstatoi se ato ishin të mirëpaisur për plotësimin e kërkesave të moduleve për aftësimin teoriko-praktik të studentëve. [RVB, Evidenca A.2.13.2. Planimetria , tabela 16 e RVB, vizita në institucion]			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në takimet me stafin u informuam se institucioni disponon 2 laboratorë të teknologjisë së informacionit të paisur me programe profesionale. Këto laboratorë janë në funksion të mësimdhënies por dhe të punës kërkimore dhe projekteve të institucionit. [takimet me GVB dhe stafin]			
Konkluzione	Programi profesional “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” përgatit profesionistë me njohuri të gjera praktike në menaxhimin e rasteve të asistencës geriatrike, rehabilituese apo asistencës për fëmijët. Institucioni ka siguruar mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike – praktike. Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në syllabuset e lëndëve të programit të studimit detajohet literatura bazë dhe literatura e rekomanduar. Literatura bazë ofrohet në gjuhën shqipe (që është gjuha e programit të studimit). Literatura bazë është në përgjithësi e 10 viteve të fundit, përbëhet nga publikime të lektorëve dhe cikle leksionesh të përgatitura dhe përditësuara çdo vit prej tyre. Ciklet e leksioneve iu dërgohen studentëve dhe në mënyrë digjitale. <i>[Evidenca A.3.9. Syllabuset e lëndëve, vizita në bibliotekë]</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e institucionit është e organizuar në disa njësi dhe siguron mundësi shfrytëzimi të barabartë dhe pa kufizime, pa pagesë për studentët. Në Kampusin 1 ka një hapësirë bibliotekë (40m²) me 18 poste leximi. Në kampusin 2 biblioteka organizohet në tre njësi funksionale : – Njësia 1: 27.3m² me 18 poste leximi. Kjo njësi shërben si bazë për arkivimin e librit fizik – Njësia 2: 95.1m² me 50 poste leximi. Kjo njësi veç librit fizik krijon mundësi përdorimi të periodikëve dhe revistave shkencore. Një pjesë e posteve në këtë njësi janë të paisura me kompiuter për akses direkt në bibliotekën on line. – Njësia 3: 70m² me 28 poste leximi. Kjo njësi ka të njëjtën strukturë me njësinë 2. Biblioteka ofron një fond fizik prej 5250 titujsh. Biblioteka ofron për përdoruesit mundësi të shumta eksplorimi të literaturës on line përmes 11 programeve të aksesueshme prej saj. Biblioteka ofron dhe katalogun digital. Katalogu shërben dhe për menaxhimin e librit. Studentët dhe personeli akademik mund të shfrytëzojnë në ambientet e institucionin dhe bibliotekën on-line (ECONBIZ, J-STORE,

	SEARCH4LIFE) <i>[Evidenca A.2.14. Infrastruktura e bibliotekës, tabela 17 e RVBsë, vizita në institucion]</i>
Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Në dokumentacionin e bibliotekës dhe në vizitën në ambientet e saj konstatuam se në bibliotekë gjenden të depozituara librat e rekomanduar në syllabuset e programit të studimit. Ndërkohë që 126 janë titujt që i përkasin programeve të studimit me natyrë mjekësore në përgjithësi. Literatura bazë që mbulon të gjitha modulet e programit të studimit gjendet si fond fizik në bibliotekë. Pasurimi periodik i fondit të bibliotekës dhe shtimi i aksesit në bibliotekat on-line janë prioritete të UniBa. <i>[Evidenca A.2.14. Infrastruktura e bibliotekës, tabela 17 e RVBsë, vizita në institucion]</i>
Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka e institucionit ka një numër optimal postesh leximi për të siguruar akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët në fondin fizik dhe në bibliotekat on line. Salla e librit akademik dhe literatura e detyruar gjenden në pjesën e bibliotekës klasike. Salla ka rreth 20 poste individuale dhe rreth 70 poste në tavolina me 4 që mundësojnë lexim dhe këmbim materiale. Në takim me punonjësit e bibliotekës u informuam se interesi i studentëve është i vogël. Tërheqin libra por pak e shfrytëzojnë për qëndrime të gjata. Institucioni ka siguruar gjithashtu akses për studentë dhe pedagogë nga platformat individuale në bibliotekën digitale JSTOR dhe në disa biblioteka të tjera. Kjo shton mundësinë për punë të pavarur sidomos në eksplorimin e publikimeve në revista e periodikë. Në takimin me punonjësit e bibliotekës u informuam se fondi i literaturës së detyruar sipas syllabuseve është i plotë në bibliotekë. Institucioni ka një politikë përditësimi dhe shtimi të fondit ekzistues në mbështetje të këtij programi por dhe programeve në tërësi. Propozimi për libra të rinj paraqitet i argumentuar nga shefat e departamenteve dhe më tej i drejtohet zyrës së financës. <i>[Evidenca A.2.14. Infrastruktura e bibliotekës, tabela 17 e RVBsë, vizita në institucion]</i>
Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të	Biblioteka siguron literaturë fizike dhe digjitale/on line në ndihmë të studentëve dhe stafit akademik. UniBa ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentet

tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.	mund të konsultohen me materiale në gjuhë të huaj. Biblioteka vë në dispozicion katalogun e saj elektronik, me standard ndërkombëtare i cili ofron një version të avancuar në kërkimin e informacion si dhe falas në formatin elektronik artikuj, teza etj. Menaxhimi realizohet përmes platformës on line, proces që ndiqet dhe lehtësohet nga punonjësit e bibliotekës. <i>[Evidenca A.2.14. Infrastruktura e bibliotekës, tabela 17 e RVBsë, vizita në institucion]</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u konstatua se biblioteka funksionon çdo ditë të javës në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Institucioni ka punonjës të veçantë për bibliotekën të cilët përgjigjen për mirëmbajtjen dhe nevojave të studentëve. Sistemi i menaxhimit on line mundëson përdorimin e fondit dhe kërkimin edhe kur studentët apo stafi nuk janë prezent fizikisht në institucion. <i>[Evidenca A.2.14. Infrastruktura e bibliotekës, tabela 17 e RVBsë, vizita në institucion]</i>
Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.	UniBa planifikon çdo vit buxhet të veçantë për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj apo përditësim të fondit ekzistues në funksion të programeve mësimore. Propozimet për titujt apo tekste vijnë nga departamentet e fakulteteve dhe përgatiten nga stafi i bibliotekës i cili përgatit listën e teksteve të kërkuara me buxhetin përkatës dhe dorëzon në rektorat. Punonjësit e bibliotekës bëjnë njoftime periodike për sistemin e menaxhimit, mënyrën e përdorimit të sistemeve on line apo përmdryshimet dhe përditësimin e fondit të librave fizike dhe on line. <i>[Evidenca A.2.19 Lista e teksteve në bibliotekë]</i>
Konkluzione	<i>Në syllabuset e lëndëve të programit të studimit detajohet literatura bazë dhe literatura e rekomanduar. Literatura bazë ofrohet në gjuhën shqipe. Literatura bazë që mbulon të gjitha modulet e programit të studimit gjendet si fond fizik në</i>

	<i>bibliotekë. Biblioteka e institucionit është e organizuar në disa njësi dhe siguron mundësi shfrytëzimi të barabartë dhe pa kufizime, pa pagesë për studentët. Biblioteka ofron një fond fizik prej 5250 titujsh. Biblioteka ofron për përdoruesit mundësi të shumta eksplorimi të literaturës on line përmes 11 programeve të aksesueshme prej saj. Biblioteka e institucionit ka një numër optimal postesh leximi për të siguruar akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët në fondin fizik dhe në bibliotekat on line. Pasurimi periodik i fondit të bibliotekës dhe shtimi i aksesit në bibliotekat on-line janë prioritet të UniBa. UniBa planifikon çdo vit buxhet të veçantë për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj apo përditësim të fondit ekzistues në funksion të programeve mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	UniBa disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Sekretaria mesimore dokumentacionin e ruan në dy forma shkresore dhe elektronike. Ajo është përgjegjëse për regjistrat, hedhjen e të dhënave dhe për marrëdhëniet me studentët. Studentët shfrytëzojnë portalin studentor, platformat LMS dhe Classroom. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë portal ku në mënyrë konfidenciale mer informacion për rezultatet e provimeve, regjistrohet në lëndët që do të frekuentoj apo provimet që do të jap gjatë vitit akademik. Studentët e regjistruar pajisen me librezë student. Sekretaria mësimor ka në formë shkresore: – Rregjistrin themeltar të studentëve – Rregjistrin me të dhënat akademike – Rregjistrin e lëshimit të diplomave Rregjistrat ruhen pa afat dhe arkivohen në arkivën e shtetit.

	Sekretaria mësimore arkivon : - Dosjet e pranimit dhe regjistrimit të studentëve me gjithë dokumentacionin përkatës - Proçes verbalet e testime në provime . - Dosjet e diplomimit. - dokumentacionin që verifikon plotësimin e kushteve për diploma, proçes verbalet e notave të provimit/temave të diplomës - listën e të diplomuarve përcjellë rektoratit për miratim, fotokopje të diplomave të tërhequra. <i>[Evidenca A.1.34. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit, takimet dhe vizita në institucion]</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativë të angazhuar në realizimin e programit mësimor. Gjatë vizitës në institucion u verifikua se Institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, i cili funksionon në bazë të rregullores përkatëse. Staf i akademik dhe studentët kanë akses për informacione apo dokumenta të nevojshëm në dobi të programit të studimit. <i>[Evidenca A.1.34. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit, takimet dhe vizita në institucion]</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UniBa disponon sistem për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe sisteme për menaxhimin e të dhënave administrative dhe akademike që mirëmbahen dhe funksionojnë të sinkronizuara. Studentët dhe personeli kanë akses individual në të dhënat personale (arritjet akademike) dhe në të dhënat që lidhen me programin e studimit (lektorët, orari mësimor, lëndët, sezonet e provimeve etj.). <i>[Evidenca A.1.34. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit, takimet dhe vizita në institucion]</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe	Institucioni ka ndërtuar një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit i cili është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët dhe stafi akademik përmes logimit me kredencialet individuale Në takimet me stafin, studentët, sekretarinë u informuam që përdorimi i adresave

shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	zyrtare të emailit është bërë mënyra kryesore e komunikimit on line për kërkim dhe transmetim informacioni midis tyre. Periudha e pandemisë e bëri të detyrueshëm këtë komunikim që është përmirësuar duke krijuar mundësi për transmetim të shpejtë të informacionit të kërkuar. Në vijim të periudhës së mësimit on line, në institucion vijon të përdoret me efektivitet platforma Google Classroom që i mundëson studentit një përjasje interaktive me programin, syllabuset, materialet didaktike dhe leksionet e pedagogëve etj. <i>[Evidenca A.1.34. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit, takimet dhe vizita në institucion]</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mësimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundësinë e monitorimit në kohë reale të të gjitha të dhënave dhe mundësinë e gjenerimit e raporteve në lidhje me frekuentimin, rezultate etj. Kjo llogari mundëson pasqyrimin e aktivitetit akademik semestral dhe komunikimin midis stafit për problematikat që lindin nga pasqyrimi i vlerësimit në sistem. <i>[Evidenca A.1.34. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit, takimet dhe vizita në institucion]</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	Faqja zyrtare e UniBa përmban informacionet kryesore në lidhje me Universitetin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organogramën. Faqja zyrtare jep informacion mbi fakultetet, kërkimin shkencor, shërbime të tjera që ofrohen nga UniBa, programet mësimore që ofron çdo fakultet sipas departamenteve. Faqja zyrtare përmban gjithashtu informacion mbi aktivitetet e organizuara nga. <i>[Evidenca – faqja ëeb e UniBa]</i>
Konkluzione	UniBa disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Sekretaria mësimore dokumentacionin e ruan në dy forma shkresore dhe elektronike. Ajo është përgjegjëse për regjistrat, hedhjen e të dhënave dhe për marrëdhëniet me studentët. Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativë të angazhuar në realizimin e programit mësimor. UniBa disponon sistem për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe sisteme për menaxhimin e të

	<i>dhënave administrative dhe akademike që mirëmbahen dhe funksionojnë të sinkronizuara. Studentët dhe personeli kanë akses individual në të dhënat personale dhe në të dhënat që lidhen me programin e studimit. Në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mësimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundësinë e monitorimit në kohë reale të të gjitha të dhënave dhe mundësinë e gjenerimit e raporteve në lidhje me frekuentimin, rezultate etj. Faqja zyrtare e UniBa përmban informacionet kryesore në lidhje me Universitetin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organogramën, ofertën akademike etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen studentëve

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Çdo vit akademik UniBa harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Hartimin e këtij plani e realizon Zyra e Financës dhe buxheti miratohet nga Bordi i Administrimit. Fondet burojnë nga buxheti i shtetit, të ardhurat e universitetit nga shërbimet që UniBa ofron për aktorë të tretë si dhe tarifat e studentëve. Shpërndarja bëhet në bazë të nevojave që paraqesin njësitë kryesore në bazë të kërkesave të planifikuara në çdo fillim viti akademik. <i>[Evidencat A.1.38. Burimet financiare UniBa, A.1.38.1. Raport vjetor institucional, A.1.38.2. Raport Auditim 2022, Tabela 18 e RVBsë, vizita dhe takimet në institucion]</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në	Çdo vit akademik njësia kryesore, në bazë kërkesave dhe planifikimeve të Departamentit, harton buxhetin i cili miratohet nga bordi i administrimit. Pjesë e buxhetit janë tarifat e shkollimit të studentëve. Institucioni harton dhe miraton tarifat e shkollimit për çdo program bazuar në VKM

shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	638 datë 22.07.2015. Tarifat e shkollimit nuk e kalojnë koston e programit të studimit. Buxheti përfshin pagat e stafit akademik dhe mbështetës, tarifat e shkollimit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor apo shpenzime të tjera në funksion të realizimit të programit; investimet, grante e fituara, kontratat e shërbimeve në funksion të programeve të studimit dhe aktivitete trainuese. Institucioni përgatit raporte financiare vjetore ku paraqiten të dhënat mbi aspektet ekonomike të programeve të studimit, buxhetin dhe zërat e tij si dhe kontrollin financiar. <i>[Evidencat A.1.38. Burimet financiare UniBa, A.1.38.1. Raport vjetor institucional, A.1.38.2. Raport Auditim 2022, A.2.15 Të ardhurat financiare 20-23, Tabela 18 e RVBsë, vizita dhe takimet në institucion]</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në republikën e Shqipërisë kryen auditim të brendshëm financiar. Që nga viti 2017, Institucioni realizon dhe auditim të jashtëm me kompaninë audituese Grant Thornton. Raportet e këtij auditimi raportohen në QKB. Institucioni auditohet në mënyrë periodike nga Ministria e Arsimit dhe kontrolli i lartë i shtetit. Auditë vlerëson aktivitetin financiar të institucionit. <i>[RVB, Takimet dhe vizita në institucion]</i>
Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në fund të çdo viti institucioni harton raportet financiare për realizimin e buxhetit si dhe përgatit buxhetin afat mesëm për funksionimin e institucionit dhe programeve të studimit. Hartimi i buxhetit mbështetet në kërkesat dhe planifikimi që bën çdo fakultet. Raporti i auditimit të brendshëm miratohet nga Administratori dhe i vihet në dispozicion drejtuesve të njësive bazë dhe njësive kryesore. <i>[Evidenca 1.30 Raporti vjetor, RVB, Takimet dhe vizita në institucion]</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësive bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre	Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifatat e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet që kryhen. Qëndrueshmëria financiare evidentohet në analizën e auditimeve në vite. <i>[Evidencat A.1.38. Burimet financiare UniBa, A.1.38.1. Raport vjetor institucional, A.1.38.2. Raport Auditim 2022,</i>

programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	A.2.15 Të ardhurat financiare 20-23, Tabela 18 e RVB-së, vizita dhe takimet në institucion]			
Konkluzione	Çdo vit akademik UniBa harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Çdo vit akademik njësia kryesore, në bazë kërkesave dhe planifikimeve të Departamentit, harton buxhetin i cili miratohet nga bordi i administrimit. Shpërndarja bëhet në bazë të nevojave që paraqesin njësitë kryesore në bazë të kërkesave të planifikuara në çdo fillim viti akademik. Institucioni në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në republikën e Shqipërisë kryen auditim të brendshëm financiar. Që nga viti 2017, Institucioni realizon dhe auditim të jashtëm me kompaninë audituese Grant Thornton. Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton	UniBa është institucion jo publik i arsimit të lartë i cili bazon

dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	aktivitetin e vet në bazën ligjore aktuale në fuqi dhe dekretet e përvitëshme të cilat dalin nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR). Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin dhe rregulloren. Edhe për administrimin e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim, në këto akte janë parashikuar procedurat e regjistrimit, mësimdhënies, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit. Rregullorja e programit të studimit “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” është hartuar në përputhje me objektivat e programit të studimit duke respektuar lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe studentëve. <i>[Evidencat A. 1.1. Statuti i UniBa, A.1.3. Rregullore e UniBa, 1.3.3. Rregullore e programit të studimit]</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Për pranimin dhe regjistrimin e studentëve në Programin Profesional “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” Institucioni bazohet në udhëzimet e MASR dhe të maturës shtetërore, duke zbatuar jo vetëm procedurat por edhe afatet përkatëse. Kriteret dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët studentë të këtij programi studimi. Institucioni ofron bursa kriteret e aplikimit të të cilave publikohen në faqen zyrtare të institucionit. <i>[Evidencat A. 1.1. Statuti i UniBa, A.1.3. Rregullore e UniBa, 1.3.3. Rregullore e programit të studimit]</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Në faqen zyrtare të institucionit publikohen çdo vit kriteret, kuotat për çdo program studimi, procedurat e pranimi dhe informacioni i nevojshëm që nga aplikimi, regjistrimi dhe matrikullimi, GVJ vlerëson se informacionet janë të sakta dhe transparente. Kriteret e pranimi në Programin Profesional “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” përcaktohen në rregulloren e programit të studimit. Kriteret e pranimi lidhen me përmbushjen e detyrimeve të maturës shtetërore dhe pagesën e tarifës së shkollimit. <i>[Evidencat A. 1.1. Statuti i UniBa, A.1.3. Rregullore e UniBa, A.3.3. Rregullore e programit të studimit, A1.20. Manual rekrutimi]</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të	Në rregulloren e programit të studimit gjendet informacion i plotë dhe i detajuar për procedurat dhe kriteret e përparimit akademik të studentëve, procedurat e transferimit, frekuentimit, ndërprerjes dhe rifillimit të studimeve. Java e

studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	parë shërben si javë informimi ku studenti njihet me dokumentacionin zyrtar dhe shërbimet që ofron institucioni. Koordinatori i departamentit, dekani i studentëve dhe sekretaria mësimore janë vazhdimisht në kontakt me studentët për orientimin dhe informimin e tyre. Koordinatori i programit është pranë studenteve në çdo kohë, me qëllim asistencën e tyre gjatë tërë periudhës së studimit deri në diplomim. Sekretaria mësimore informon studentet për orarin e mësimi, provimeve dhe çdo detaj në lidhje me procesin akademik. <i>[Evidencat A. 1.1. Statuti i UniBa, A.1.3. Rregullore e UniBa, 1.3.3. Rregullore e programit të studimit, takimet në institucion me studentët, sekretarinë mësimore, dekanin e studentëve]</i>
Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UniBa mbështetur në kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe akteve rregullatore në fuqi, përpilon akte rregullatore për kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve përfshi kandidatët me aftësi të veçantë, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Kriteret e përgjithshme dhe specifike të regjistrimit publikohen dhe në portalin u-Albania. Për programin OPKSH nuk ka kritere të veçanta për përzgjedhjen e këtyre kategorive. Megjithatë tarifat favorizuese të programit janë inkurajuese për kategoritë e mësipërme që janë zakonisht dhe më të interesuara për programe që të integrojnë shpejt në tregun e punës. <i>[Evidencat A. 3.16. Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve, takimet në institucion]</i>
Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe bazuar në kriteret e përcaktuara me akte të brendshme rregullatore, UniBa ofron bursa të ndryshme studimi. Institucioni ofron bursa studimi për studentë me mesatare të lartë (>8.5) dhe për studentë me përkrahje sociale. Kriteret e aplikimit publikohen në faqen zyrtare të institucionit. KA patur mbështetje me bursa sociale në këtë program studimi. <i>[Evidencat A. 1.1. Statuti i UniBa, A.1.3. Rregullore e UniBa, takimet në institucion]</i>
Konkluzione	UniBa është institucion jo publik i arsimit të lartë i cili bazon aktivitetin e vet në bazën ligjore aktuale në fuqi dhe dekretet e përvitëshme të cilat dalin nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Institucioni disponon akte rregullatore

	për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin e universitetit. Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të miratuara nga Senati Akademik, zbaton procedura, të cilat garantojnë të drejta të njëjta, për të gjithë studentët. Kriteret dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët studentë të këtij programi studimi. Në faqen zyrtare të institucionit publikohen çdo vit kriteret, kuotat për çdo program studimi, procedurat e pranimit, transferimit, dhe informacioni i nevojshëm që nga aplikimi, rregjistrimi dhe matrikullimi. Kriteret e përgjithshme dhe specifike të regjistrimit publikohen dhe në portalin u-Albania. Sekretaria mësimore informon studentet për orarin e mësimet, provimeve dhe çdo detaj në lidhje me procesin akademik. Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe bazuar në kriteret e përcaktuara me akte të brendshme rregullatore, UniBa ofron bursa të ndryshme studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Studentët që ndjekin programin mësimor “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. Në dosjen e programit të studimit ata gjejnë: – Informacion mbi institucionin që ofron programin e studimit – Informacion për objektivat formuese të programit – Strukturën dhe organizimin e programit – Planin mësimor – Syllabuset

	– Rregulloren e programit të studimit Studentët informohen dhe për paketën e praktikës, komponent mjaft i rëndësishëm i formimit të tyre profesional. Në informimin e studentëve një rol të veçantë kanë strukturat administrative të UniBa veçanërisht sekretaria mësimore dhe dekani i studentëve, materialet promocionale të prodhuara nga institucioni dhe organizimet studentore të pranishme në formën e klubeve studentore në UniBa. Java e parë e pranimit është javë akomodimi-orientimi gjatë së cilës studentët njihen me gjithë dokumentacionin dhe shërbimet në funksion të tyre. <i>[Evidenca A.3.3. Rregullore e programit të studimit, takimet në institucion me studentët, sekretarinë mësimore, dekanin e studentëve]</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstatoi se UniBa në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret e institucionit ka informacion në lidhje me transferimet dhe programet e dyta të studimit. Studentët marrin informacion në lidhje me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Për plotësimin e procedurave të transferimit, institucioni aplikon Rregulloren e transferimeve si dhe ka ndërtuar një manual për të gjitha lëvizjet e mobilitetet që nga rekrutimi, aplikimi, regjistrimi, transferimi. <i>[Evidencat A.1.3. Rregullore e UniBa, A.3.3. Rregullore e programit të studimit, A1.20. Manual rekrutimi]</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në rregulloret e institucionit dhe rregulloret e programit të studimit që i vihen në dispozicion studentit që në momentin e regjistrimit si dhe në syllabuset e detajuara të lëndëve gjendet informacioni i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive në këtë program studimi. <i>[Evidencat A.1.3. Rregullore e UniBa, A.3.3. Rregullore e programit të studimit, A3.9. Syllabuset, Takimet në institucion]</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit	Në rregulloret e institucionit dhe rregulloret e programit të studimit që i vihen në dispozicion studentit që në momentin e regjistrimit gjendet informacioni i plotë për procedurën e diplomimit. Në mënyrë specifike, rregullorja e programit të

përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.	studimit OPKSH parashikon mbylljen e detyrimeve me provim përfundimtar pasi programi është program profesional. Studentët njihen me procedurën dhe në takimet informuese të realizuara nga departamenti. Në fillim të vitit të dytë ata mjihen me programin e provimit përfundimtar tematika të caktuara të të cilit i diskutojnë me pedagogët në formë konsultimi. <i>[Evidencat A.1.3. Rregullore e UniBa, A.3.3. Rregullore e programit të studimit, Takimet në institucion]</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Mbështetur në informacionet e marra në institucion dhe në dokumentacionin e vlerësuar GVJ konstaton se UniBa ka zyrën e pranimit strukturë që në bashkëpunim me strukturat drejtuese të institucionit merr pjesë në promovimin e programeve të studimit përpara fillimit të çdo viti shkollor dhe në mënyrë periodike. Zyra e pranimit publikon në mënyrë periodike informacione për afatet e aplikimit dhe regjistrimit në programet e studimit. UniBa merr pjesë në Panairret Ëork & Study të organizuara nga MAS dhe organizon orët e hapura për maturantët. Gjithashtu ofron informacion me anë fletëpalosjeve, faqes zyrtare ëeb, rrjeteve sociale, etj. <i>[Evidencat A.3.11 Open Day për maturantët, Faqja ëeb, materialet promocionale në ambientet e institucionit, takimet në institucion]</i>
Konkluzione	Studentët që ndjekin programin mësimor "Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore" informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. Studentët marrin informacion në lidhje me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimeve parashikohet procedura e transferimeve. Studentët marrin informacion të plotë për mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe provimin përfundimtar. Këto informacione të shkruara në rregullore e syllabuse përditësohen dhe shpjegohen nga stafi akademik i përfshirë në programin e studimit. Për promovimin e programeve të studimit UniBa merr pjesë aktive në Panairret Ëork & Study të organizuara nga MAS dhe organizon orët e hapura për maturantët. Gjithashtu ofron informacion me anë

	<i>fletëpalosjeve, faqes zyrtare ëeb, rrjeteve sociale, etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ bazuar në dokumentat referuese (planet mësimore, rregullore, statutt), takimet me drejtues të institucionit, sekretarinë mësimore, dhe studentët konstaton se, UniBa vendos në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit të programit mësimor dhe kohëzgjatjes së programit të studimit. Informacionin studentët e marrin nëpërmjet takimeve me stafin akademik që i pret në institucion në momentin që interesohen për programet e studimit, nëpërmjet kontakteve me Zyrën e Karrierës dhe stafin pedagogjik, si dhe vënies në dispozicion të studentëve të rregullores së brendshme dhe rregullores së programit të studimit. Java e parë e orientimit është mjaft e rëndësishme për vendosjen e kontakteve, marrjen e informacionit dhe ambientimin. Studentët që aplikojnë për këtë program studimi informohen dhe përmes faqes ëeb apo në aktivitetet “open day” të dedikuara për promovimin e programeve të studimit në maturanët e interesuar. Në takimin me zyrën e pranimit u informuam se ende ka pak interes primar në maturanët për këtë program studimi. Favorizohen personat që nuk kanë notë mesatare dhe duan të dalin më shpejt në tregun e punës. Ka pak informacion për njohjen e diplomës në hapësirën europiane. Institucioni ka krijuar një bashkëpunim me gjimnazin e Kamzës pasi ky institucion ka një program të ngjashëm. <i>[Evidencat A.3.11 Open Day për maturanët, Faqja ëeb, materialet promionale në ambientet e institucionit, takimet në institucion]</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve	Në takimet e kryera në institucion me drejtuesin e departamentit, stafin akademik si dhe nga shqyrtimi i

informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	dokumentacionit në dispozicion GVJ konstatoi se studentët e programit të studimit profesional OPKSH informohen që në fillim të vitit në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe kanë në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit. Po ashtu në orën e parë studentët marrin informacion të detajuar nga pedagogët e lëndëve për syllabusin përkatës ku shprehen qartë: kreditet, kodi lëndor, raporti leksion/seminar/laborator/praktikë, temat, literaturë bazë dhe literaturën e rekomanduar, format e kontrollit dhe vlerësimit, detyrimet për lëndën (projekte, detyra kursi), niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës etj. <i>[Evidenca A.3.9. Syllabuset, Faqja ëeb, Takimet në institucion]</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Zyra e ALUMNI dh e karrierës drejton koordinimin me biznesin, informimin e studentit, mbikqyr dhe organizon aktivitete për studentet si leksionet e hapura, bën publikim periodik për oferta pune. Në takimet ton alumni të suksesshëm për të ndarë eksperiencën studentore dhe karrierën profesionale me studentët aktualë. Institucioni ka një database që shërben për ruajtjen e informacionit dhe për të mbajtur lidhje. Zyra e ALUMNI dhe e karrierës mbështet studentin dhe orienton në drejtim të tregut të punës. Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe gjithë informacionin që merr nga agjensi punësimi, megjithëse i mungojnë statistikak e sakta. Pjesëmarrja në panairin “Ëork and study” është një risi në këtë fushë. <i>[Evidencat A.1.33.2.Rregullore e zyrave studentore dhe keshillimit te karrieres, A.2.16. Vendim i bordit të karrierës, faqja ëeb, takimet në institucion]</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në dosjen e programit të studimit studenti informohet dhe për infrastrukturën e programit të studimit. Numri i klasave dhe laboratorëve është optimal dhe nga vizita në universitet konstatojmë që janë OK. Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në institucione spitalore dhe të ofrimit të kujdesit specifik. Në funksion të studentëve është dhe biblioteka dhe shërbimet e sekretarisë. Studentët kanë komunikim të vazhdueshëm me Koordinatorin e departamentit, Dekanin e studentëve dhe Sekretarinë mësimore për informim rreth detajeve të procesit mësimor.

	Komunikimi me email vlerësohet dhe aplikohet si mjet i shpejtë dhe efikas komunikimi në distancë. Platforma e studentit është mjaft funksionale dhe i ndihmon ata në përditësimin e informacionit. GVJ në takimin me studentët evidentoi që studentët informohen hollësisht dhe gjëresisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimi, aktivitet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse. <i>[Evidencat A.1.3. Rregullore e UniBa, A.2.7. Rregullore e departamentit, dosja e programit të studimit, vizita dhe takimet në institucion]</i>
Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Praktika profesionale është komponent i rëndësishëm i programit dhe planit mësimor. Referuar tabelave të programit të studimit, praktika realizohet e ndarë në 4 semestra dhe ka 24 ECTS të realizuara në 240 orë në auditor/360 orë punë e pavarur (6 ECTS-150 orë në çdo semestër). Studentët orientohen për kryerjen e praktikave pranë institucioneve me të cilat UniBa ka marrëveshje bashkëpunimi. <i>[Evidencat A3.6.Paketa e praktikës, marrëveshjet e bashkëpunimit, takimet në institucion]</i>
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentat referuese (planet mësimore, rregullore, statutt), takimet me drejtues të institucionit, sekretarinë mësimore, dhe studentët konstaton se, UniBa vendos në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit të programit mësimor dhe kohëzgjatjes së programit të studimit. Studentët që aplikojnë për këtë program studi informohen dhe përmes faqes ëeb apo në aktivitetet "open day" të dedikuara për promovimin e programeve të studimit në maturanët e interesuar. Java e parë e orientimit është mjaft e rëndësishme për vendosjen e kontakteve, marrjen e informacionit dhe ambientimin. Informimi është i vazhdueshëm përmes komunikimeve me koordinatoren e programit, pedagogët, sekretarinë mësimore dhe komunikimit on line. Studentët orientohen për kryerjen e praktikave pranë institucioneve me të cilat UniBa ka marrëveshje

	bashkëpunimi. Zyra e ALUMNI dhe e karrierës mbështet studentin dhe orienton në drejtim të tregut të punës. Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe gjithë informacionin që merr nga agjensi punësimi, megjithëse i mungojnë statistikatat e sakta. Pjesmarrja në panairin "Ëork and study" është një risi në këtë fushë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	UniBa disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit që përdoren për kryerjen e analizave dhe raporteve vjetore. Informacioni ruhet dhe depozitohet në sekretarinë mësimore të institucionit. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për të siguruar statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Referuar tabelës 23 të RVBsë, numri total i të diplomuarve në programin e studimit OPKSH për periudhën 2021 – 2023 është 6 (gjashtë). Nuk ka të dhëna për punësimin e të diplomuarve. Referuar tabelës 21 të RVBsë numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në këtë program studimi është 3 (tre) për vitin akademik 2022 – 2023 dhe 5 (pesë) për vitin akademik 2023 – 2024. Ka dhe një student të transferuar në vit të dytë për vitin shkollor 2023 – 2024. Nga diskutimi me stafin akademik dhe drejtuesit e institucionit u referua se numri i studentëve për këtë program studimi vijon të jetë i ulët. GVJ sugjeroi një bashkëpunim më të mirë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe urdhërin e infermierit për përfshirjen e diplomës në organikat e punësimit gjë që do të shtonte interesin për këtë program

	studimi. <i>[Evidenca A.1.21. Rregullore për funksionimin e sekretarisë mësimore, tabelat e RVBsë, Takimet në institucion]</i>
Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore e UniBa menaxhon të dhënat statistikore të studentëve përmes sistemit të brendshëm të informacionit, të cilat për të qenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar ruhen në formë të printuar dhe elektronike. Të dhënat e studentëve menaxhohen dhe përmes portalit studentor. Përmes llogarive personale, studentët marrin informacion në kohë reale për rezultatet akademike dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për ta. <i>[Evidenca A.1.21. Rregullore për funksionimin e sekretarisë mësimore, A.1.34. Udhëzues për përdorimin e strukturës TIK, tabelat e RVBsë, Takimet në institucion]</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Sipas RVB dhe nga takimet e zhvilluara në Institucion, GVJ konstaton se njësitë përkatëse të administratës në UniBa, Dekanati dhe Departamenti, mbështesin me akte përkatëse kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin: sekretarinë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, duke mundësuar vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes, saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre. Secili nga aktorët, ka akses në çdo kohë për vlerësimin apo kontrollimin e veprimtarisë administrative apo mësimore. <i>[Evidenca Takimet dhe vizita në institucion]</i>
Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Raportet analitike përpilohen në formën e analizës vjetore (evidencat e analizave gjenden në dokumentacion). Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimi dhe diplomimin. Në raportet analitike të departamentit ka dhe sugjerime mbi masat që duhen marrë për përmirësimin e treguesve. Departamenti bashkërendon punën me zyrën Alumni për ndjekjen e shkallës së punësimit të studentëve dhe orientimin e tyre në tregun e punës. <i>[Evidencat A.1.30. Raporti vjetor UniBa 22-23, A.2.10. Raporti vjetor në DSHSHS 2021-2022/2022 – 2023, Takimet në institucion]</i>
Konkluzione	<i>UniBa mbledh, administraton, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin dhe profilin e studentëve</i>

	që ndjekin programin e studimit profesional në "Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore", nga pranimi deri në diplomim, si dhe bën përpjekje për grumbullimin e të dhënave mbi punësimin e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e institucionit, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UniBa. Në RVB theksohet se studentët janë të përfaqësuar në Senatin e UniBa, në Këshillin e etikës dhe shanseve të barabarta, në NJSBC. Studentët organizohen në Këshillin studentor. Studentët kanë qenë pjesmarrës dhe në hartimin e RVB. Departamentet organizojnë mbledhje të hapura me pjesmarrjen e studentëve. [Evidencat A. 1.1. Statuti i UniBa, A.1.3. Rregullore e UniBa, A.1.33.1. Politika të mbështetjes, përkrahjes së studentëve dhe struktura organizative të tyre, A.1.33.5. Manuali i klubeve studentore takimet në institucion]
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura (kriteri 1) por dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Në takimin me studentët GVJ konstaton se studentët plotësojnë pyetsorë në mënyrë periodike për secilën lëndë dhe pedagogë. Pyetsorët përgatiten dhe informacioni i mbledhur përpunohet nga NJSBC. Studentët shprehen të kënaqur për komunikimin me stafin akademik dhe ndihmësakademik në institucion. [Evidencat A.1.11. Formular vlerësimi, takimi me studentët]

	<i>dhe NJSBC]</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Për tërheqjen e mendimit të studentëve në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, institucioni përdor një seri mekanizmesh. Këshilli studentor është organizmi ku studentët debatojnë dhe problematikat e trajtuara i adresojnë në forumet drejtuese të UniBa për zgjidhje. Dekani i studentëve dhe koordinatori i departamentit janë në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërbejnë si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale. Pyetësorët e plotësuar nga studentët janë një tjetër mekanizëm për tërheqjen e mendimit të tyre. Pyetësorët realizohen çdo vit, 2 herë në vit për secilën lëndë. Nga të dhënat e mbledhura e të përpunuara dalin sugjerimet për përmirësim e cilësisë së mësimdhënies. Për tërheqjen periodike të mendimeve dhe sugjerimeve cilësore të studentëve departamentet organizojnë takime periodike me fokus grupe studentësh. <i>[RVB, takimet në institucion]</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvehtësojnë sa më shumë dije. <i>[Evidencat A.1.3. Rregullore e UniBa, A.3.3. Rregullore e programit të studimit, Takimet në institucion]</i>			
Konkluzione	UniBa përfshin dhe organizon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit. Në organizimin dhe koordinimin e veprimtarisë së studentëve rol të rëndësishëm kanë klubet studentore dhe Dekani i Studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Në funksion të informimit të studentëve janë: – Zyra e pranimit – Sekretaria mësimore – Dekani i studentëve – Zyra e Alumni dhe Karrierës – Koordinator i departamentit Sekretaria mësimore është e hapur çdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim. Dekani i studentëve, Koordinator i departamentit, Zyra e Alumni dhe karrierës ndjekin ecurinë e studentit dhe ofrojnë këshillim për çështjet akademike. <i>[Evidencat A.1.23. Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa. Evidenca A.1.21. Rregullore për funksionimin e sekretarisë mësimore]</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar në Kriterin 1 është funksional dhe i përshtatshëm. Studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor. Studentët inkurajohen për zhvillimin e aftësive të tyre përmes përfshirjes në klube studentore me profile të caktuara. Në takimin me dekanin e studentëve dhe vizitën në ambientet e bibliotekës GVJ u njoh me klubin e medias dhe revistën studentore të UniBa. <i>[Takimet dhe vizita në institucion]</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe	Në institucion funksionon zyra e këshillimit të karrierës, Alumni. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre. Zyra e këshillimit të karrierës i ndihmon studentët për: – Identifikimin i lidhjeve midis diplomës që do të marrin

periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	dhe mundësive për karrierë – Identifikimin e burimeve për pozicione të veçanta pune – Zhvillimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës – Identifikimin e aftësive dhe shprehive Në këtë zyrë studentët gjejnë mbështetje për përgatitje për intervista pune, shkrimin e CV dhe letrave të motivimit etj. Zyra ofron një seri aktivitete për orientimin e studentëve në tregun e punës si Open Day, Ditët e informimit, Panairin “Ëork and Study”. GVJ diskutoi me studentët dhe GVB për mundësitë e punësimit dhe konstatoi se megjithë kërkesën e lartë të vërejtur sidomos gjatë periudhës së pandemisë, në Shqipëri pozicioni i “Operatorit dhe këshilluesit në përkujdesje shëndetësore” nuk është konfiguruar qartë në tregun e punës. <i>GVJ sugjeroi bashkëpunimin me strukturat e Urdhërit të Infermierit dhe Psikologut për integrimin më të lehtë në tregun aktual të punës.</i> <i>[Evidencat A.1.33.2 Rregullore e zyrave studentore dhe këshillimit të karrierës, takimet në institucion]</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Në takimin e GVJ me zyrën e këshillimit të karrierës u informuam se kjo njësi ka një database me informacion për punësimit dhe vijimin e studimeve (në UniBa ose institucione të tjera brenda apo jashtë vendit) të studentëve të diplomuar. Njësia e këshillimit të karrierës mban lidhje me studentët e diplomuar përmes adresave email apo komunikimeve në rrjetet sociale. Zyra e Alumni dhe Karrierës harton çdo vit raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve dhe i vë në dispozicion të organeve drejtuese të institucionit për përpilimin e strategjive në fushën e zhvillimit të programeve të studimit. Zyra ka organizuar dhe takimet Alumni ku studentët e diplomuar dhe në karrierë pune ndajnë historitë e tyre të suksesit, shkëmbejnë informacione për tregun e punës dhe krijojnë lidhje me studentët aktualë. <i>[Evidenca A.1.30. Raporti vjetor UniBa 22-23, A.1.33.2 Rregullore e zyrave studentore dhe këshillimit të karrierës, takimet në institucion]</i>

Konkluzione	<i>UniBa ka procedura dhe njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, si edhe menaxhimin e problematikave. Këto njësi janë të përherëshme dhe lehtësisht të arritshme nga studentët. Studentët inkurajohen për zhvillimin e aftësive të tyre përmes përfshirjes në klube studentore me profile të caktuara. Njësia e këshillimit të karrierës ka një database dhe mban lidhje me studentët e diplomuar përmes adresave email apo komunikimeve në rrjetet sociale. Zyra e Alumni dhe Karrierës harton çdo vit raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve dhe i vë në dispozicion të organeve drejtuese të institucionit për përpilimin e strategjive në fushën e zhvillimit të programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore”

Pika të forta dhe afirmimet:

1. Institucioni ka kapacitetet, burimet financiare dhe logjistike të mjaftueshme, që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit, si programin teorik ashtu dhe praktikën laboratorike.
2. Marrëveshjet bashkëpunimi që ka UBa me institucione shëndetësore, qendra të kujdesit për moshën e tretë dhe OJF për realizimin e programit mesimor dhe praktikës profesionale në OKPSH,
3. Ky është i vetmi program studimi në shqipëri dhe vendet e rajonit të ballkanit i ngjashëm me programe të njëjta në vendet e BE duke ju krijuar studenteve mundësi punësimi në shqipëri, vendet e rajonit ballkanik dhe me gjere në vendet e BE..
4. Stafit akademik i kualifikuar me tituj dhe grada shkencore në përputhje me ekspertizën që ofrojnë, të angazhuar në realizimin e këtij program studimi.
5. Funksionimi i bordit të karrierës i cili ndihmon në krijimin e kontaktetëve të studentëve me drejtuesit e këtyre institucioneve apo organizatave për punësimin e tyre si dhe bashkëpunimin me biznesin për përmirësimin e programit të studimit, dhe njohjen me nevojat e tregut të punës

Pika të dobta:

1. Promovimi jo i mjaftueshëm i programit të studimit me karakter profesional që gjykohet i rëndësishëm për tregun e punës dhe komunitetin
2. Mungesa e njohjes së profesionit “Operator dhe Këshillues në Përkujdesje” Shëndetësore nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mosklasifikimi i këtij profesioni në organogramin apo strukturën e institucioneve shëndetësore apo shërbimeve sociale (si shtëpitë e të moshuarëve, institucione të kujdesjes të personave me aftësi ndryshe etj).
3. Punësimi i ulët i studentëve që mbarojnë këtë program studimi.
4. Mungesa titullarëve të lëndëve nga kategoria profesor, në të gjitha lëndët.

Rekomandime:

GVJ rekomandon si më poshtë:

- Rishikimim e ngarkesës mësimore të stafit akademik dhe hartimin e orarit mësimor javor.
- Përditësimin dhe rishikimin e Rregullores së programit të studimit, me qëllim përcaktimin më të qartë të fushave të veprimtarisë
- Titullarët e lëndëve të përzgjidhen nga kategoria profesor.
- Komisioni i provimit të përbëhet nga të paktën nga dy pedagogë.



Conclusions of the evaluation of the study program with a professional character in "Operator and Advisor in Health Care"

Strengths and affirmations:

1. The institution has sufficient capacities, financial and logistical resources, for the development of the study program, both the theoretical part and the laboratory practices.
2. Partnership and Cooperation agreements of university UBa with health institutions, care centers for the elderly and NGOs for the realization of the education program and professional practice of "Operator and Advisor in Health Care"(OCHC) program students.
3. This is the only study program in Albania and the countries of the Balkan region, similar to the same programs in the EU countries, creating employment opportunities for students in Albania, the countries of the Balkan region and more widely in the EU countries
4. Qualified academic staff with scientific titles and degrees in accordance with the expertise they offer, engaged in the realization of this study program.
5. The functioning of the career board, which helps in creating contacts between students and the leaders of these institutions or organizations for their employment, as well as cooperation with business for the improvement of the study program, and familiarization with the needs of the labor market.

Weaknesses:

1. Insufficient promotion of a study program with professional nature that is considered important for the labor market and the community
2. Non-recognition of the profession of Operator and Advisor in Health Care" by the Ministry of Health and Social Protection and the non-inclusion of this profession in the organizational chart or structure of health institutions, social services (such as asylums, institutions for the care of persons with different abilities etc)
3. Low employment of students who finish this study program.
4. Absence of the course holders from the professor category, in all subjects.

Recommendation:

The group of external evaluators recommends as following:

- The course holders should be the academic staff of the professor category.
- Updating and Reviewing the Regulation of the study program" in order to clearly define the fields of activity.
- Review of the teaching load of the academic staff and the drafting of the weekly teaching schedule.
- The examination committee should consist of at least two lecturers.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X